

01 MARS, 2024

HEJZA

Agim Bajrami, poet

**ENDE MBISUNDON MENDËSIA
PROVINCIALE DHE LOGJIKA E MËHALLËS**

Nën thjerrë

TË GJITHA RRËFIMET MBI IDENTITETIN KULTUROR

Shqiptarët, tashmë, të paktën deklarativisht, e dëshmojnë me krenari identitetin e tyre kulturor proevropian! Por, mbi çka mbështetet identiteti kulturor i evropianëve?



Nga Avni HALIMI

Janë disa rrëfime mbi identitetin kulturor shqiptar! Qëndrimet "akademike" serbo-maqedonase (dhe të disa "shkencëtarëve" aleatë të tyre) ngrihen mbi teza tendencioze dhe ofenduese për shqiptarët! Tezat e tyre, të shprehura edhe nëpër tekste "shkencore" dhe "mësimore", ngrehin rrëfimin (serb) se "shqiptarët janë pa identitet etnik e kulturo", se janë "njerëz me bishta dhe të egër"; ngrehnin rrëfimin (maqedonas) se, shqiptarët janë "egërsira që në shekullin XIX kanë zbritur nga majat e larta të maleve dhe kanë uzurpuar tokat maqedonase!"

Te popujt evropianë identiteti kulturor është më i shenjtë se besimi

Historia, antropologjia, arkeologjia, arkivat e ndryshme botërore i përgënjeshtrojnë të gjitha këto teza shovene dhe për shqiptarët flasin si për një popull nga më të vjetrit në Evropë! Megjithatë, përditshmëria jonë nuk ngrihet mbi rrëfimin autokton për identitetin kulturor shqiptar! Cila është qasja kombëtare ndaj kulturës sonë! Cilat janë politikat kom-

bëtare për kulturë, për antropologji, për arkeologji, pastaj, për teatër, për film, për letërsi, për artizanate! Në fakt, kemi dhënë kontribute profesionale e institucionale vetëm sa për vetvete, për t'i njohur këto shkencë dhe për t'u krenuar e vetëkënaqur! Çka kemi bërë dhe sa kemi bërë që Perëndimi t'i bllokojë të gjitha rrëfimet sllave të "thurura" për identitetin tonë kulturor! Fatkeqësisht, kemi plotë kuazi-intelektualë perëndimore, madje edhe deputetë evropianë, kulturologë etj. që janë edhe më tej të impresionuar nga rrëfimet serbe-maqedonase mbi identitetin kulturor "inegzisten" të shqiptarëve! Fundja, në çka konsiston identiteti kulturor evropian i BE-së? Në "heqjen" e kufijve, vetëm në eliminimin e trerëve doganorë? Në paranë e përbashkët? Në ushtrinë dhe sigurinë e përbashkët (NATO, INTERPOL etj.)? A mund t'i kërkojë dikush gjermanëve që të heqin dorë nga identiteti kulturor gjerman në të mirë të një "identiteti evropian"! Cili do të ishte ai rrëfim mbi identitetin evropian që do t'i bindte gjermanët? Po francezët? Po italianët? Austriakët? Për ta relativizuar këtë fakt, pra, për ta mjegulluar rrëfimin e çdo etnie evropiane mbi identitetin e vet kulturor, kanë shpikur "bashkësinë

me diversitet të begatë kulturor"! Evropa, në Maqedoni, në Kosovë, në Luginë, prej shqiptarëve kërkon që ta zhvillojnë multi-kultin nëse dëshirojnë të sigurojnë ndonjë "korebukë" si përkrahje financiare për projektet e tyre kulturore! "Shoqëria e hapur" është e garantuar për maqedonasit dhe serbët vlerat e të cilëve kërkohen që të shijohen edhe nga shqiptarët! Edhe në Kosovë, më tepër përkrahen "aktivitetet internacionale" shqiptare, që nuk e vënë theksin mbi identitetin kulturor kombëtar por që angazhohen për një rrëfim të një "identiteti hibrid" përmes projekteve multi-kulti! Shqipërisë dhe Kosovës i sponsorizohen me qejf vetëm ato projekte që mund të realizohen në bashkëveprim me shtetet fqinje: Shqipëri-Mal të Zi, Shqipëri-Maqedoni e Veriut, por jo dhe Shqipëri-Kosovë! Përfundimisht, shqiptarëve u mungon rrëfimi autokton mbi identitetin kulturor, punë kjo e akademike tona, e institucioneve kulturore, e politikave dhe strategjive kombëtare mbi kulturën tonë! Kemi qindra ambasada ndërsa kemi dy-tri (apo fare!) atashe kulturor. Edhe aty ku kemi, ndonjë aktivitet kulturor më tepër do të ishte si iniciativë private se sa ndonjë aktivitet i diplomacisë kul-

turore, sesa, fatkeqësisht, mungojnë direktivat shtetërore që mbështeten në strategjitë dhe synimet kombëtare për sa i përket kulturës sonë. Po, Tirana përfundoi me sukses misionin si kryeqytet evropian i rinisë, duke realizuar rreth 1000 projekte!!! Tani do të jetë kryeqytet evropian i sportit, ishte edhe kryeqyteti kulturor kozmopolitan i Ballkanit, ndërsa shpreson që më vitin 2024 të bëhet kryeqytet evropian i kulturës! Po çka bëri dhe çka do të bëjë Tirana, respektivisht Shqipëria, për këto gatishmëri nacionale të kërkojë nder nga shtete evropiane që ta prezantojnë kulturën shqiptare nëpër shtetet e BE-së me qëllim që të njoftohen me atë rrëfim burimor mbi identitetin kulturor të shqiptarëve si komb?! Është rrëfim i mangët nëse do të flitet vetëm për mikpritjen e shqiptarëve për evropianët që kanë dëshirë të dëfrehen në kryeqytetin shqiptar, ndërkohë që shtetet evropiane nuk shprehin interesim për kulturën shqiptare. Samiti evropian për Ballkanin që u mbajt në Tiranë, dëshmoi që shqiptarët kanë potencial dhe vlerë dhe se, vetëm me një segment kulturor ia dolën që t'i mahnitin liderët evropianë dhe me kënaqësi të duartrokasin bashkërisht me artistët shqiptarë në një pikë

artistike nga thesari ynë kulturor!

Identiteti kulturor evropian dhe "ne të tjerët"

Aktualisht, mbase edhe për dekada të tëra, nuk mund të flitet për një identitet të vetëm kulturor evropian! BE-ja ka vendosur që ky identitet të jetë "multikulturalizmi" i një bashkësie të gjerë që diversitetin kulturor e ka si "dysytëballi"! Unioni i shteteve, secili me kulturë të vet nacionale dhe që përkujdesen për kulturat e ndryshme të komuniteteve dhe të bashkësive të tyre etnike. Për gjithë këto vite janë dashur shumë angazhime dhe fonde prej miliarda eurosh me qëllim që të ngrenë një strukturë kulturore që do të jetë vlera më e madhe e një Unioni të shteteve evropiane! Po "ne të tjerët" që pretendojmë të përfshihemi në këtë Union, si do t'ia bëjmë me kulturat tona? Me kulturat tona nacionale a jemi duke dhënë sinjale të forta se do t'ia dalim që të bëhemi një "vidhë konstruktive" në tërëatë strukturë kulturore evropiane tashmë të "çeliktë"! Për momentin e kemi të sigurt vetëm shijimin ngadistanca të vlerave të pacenueshme të kësaj kulture të bashkuar; të lakmojmë dhe të ëndërrojmë ditën se kur do të mund të përfshihemi institucionalisht në politikat kulturore të BE-së! Fatkeqësisht, ne të tjerët, shtetet që jemi kandidatë për t'u inkuadruar në këtë familje të madhe, me politikat kulturore që i zhvillojmë jemi shumë larg, gati në kufij e të pamundshmes që të inkuadrohemi ndonjëherë në BE! Kjo Familje e Madhe nuk do të na pranojë me "kultura problematike", me një mentalitet që kulturën e sheh si mundësi për përfitime personale, për ta manipuluar historinë nacionale, rajonale e botërore. Pra, popujt dhe shtetet me "kulturë me prirje konfliktuale", por edhe ata shtete e popujt me prirje për "tallava kulturë" as që guxojnë të shohin ëndrrën e bashkimit të madh! Sepse, kjo nuk do të mund të ndodhë asnjëherë. Nuk ka strategji, nuk ka pozitë gjeostrategjike, ushtarake, madje as ekonomi gjigante, që mund t'i anashkalojë problemet kulturore në të mirë të afrimit dhe bashkimit me BE-në! BE-ja e ka shumë të qartë rolin e kulturës dhe të industrisë kreative në zhvillimin e saj ekonomik, pra, në shtimin e mirëqenies së përgjithshme. Prandaj për strategjinë Evropë Kreative përgjatë viti 2013-2020 janë ndarë 1.8 miliardë euro. Politikë evropiane kanë detektuar se, në bruto prodhimin evropian, kultura si

dhe industria kreative arrijnë vlerën prej 4.8%, apo rreth 3.8% të të punësuarve në BE (diku rreth 8.5 milion vende pune)! Falë këtyre synimeve të politikave evropiane, gjatë vitit 2000-2007, punësimi në sektorin e kulturës dhe industrisë kreative për çdo vit ka shënuar rritje prej 3.5%! "Ne të tjerët", a mund të themi se po hartojmë strategji nacionale për t'i përcjellë këto trende evropiane në sektorin e kulturës? Jo, sepse, "ne të tjerët" akoma jemi në stadin e "ndërtimit dhe përfortimit" të identitetit kulturor, madje edhe më keq, akoma nuk jemi të prerë dhe të qartë se si do të duket identiteti ynë kulturor në 100 vitet e ardhshme! Buxhetet e kulturave tona janë për të gjeneruar "heshtje të intelektualëve" dhe nuk janë burime që gjenerojnë punësime, që hapin vende të reja pune, që nuk premtajnë kurrfarë rritje të industrisë kreative. Pra, BE-ja, përkundë fragmentarizmit kulturor e gjuhësor, me politikë të veta kulturore angazhohet fuqishëm në promovimin dhe në ruajtjen e diversitetit kulturor dhe gjuhësor si dhe në shtimin e konkurrencës, sepse vetëm kështu do të rritet punësimi, respektivisht, mirëqenia dhe zhvillimi i përgjithshëm. Në BE funksionon Strategjia e përbashkët e ngritur mbi programet e veçanta ta aktiviteteve kulturore. Dhe, sa më të ndryshme dhe më të larmishme që të jenë këto aktivitete aq më i fuqishëm do të jetë përkushtimi i shoqërisë për ta ruajtur dhe zhvilluar diversitetin kulturor, vlerë kjo mbi të cilën ngritet identiteti kulturor evropian. Me politika diskriminuese, me politika për kultivim të kultit "popull bibliko-mitik", me politika për të ngritur identitet kulturor duke shkelur identitete të tjera dhe duke ua vjedhur vlera efaktuaranë historinë botërore, nuk ka BE, sepse identiteti kulturor evropian nuk toleron që brenda vetes të ketë "trup tumoral" që paraqet problem shëndetësor! Identiteti kulturor evropian nuk mund të tolerojë që të jetë i përfshirë në asnjë konflikt identitar dhe as brenda vetes të ketë ndonjë segment kulturor konfliktual!

"Burimet" e idesë për zhvillim autonom të "kulturës provinciale"

Në fondin e dokumenteve nga politika e jashtme e Mbretërisë së Serbisë, të përfshirë në Librin i të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të

Serbisë, gjendet edhe një letër e Nikolla Pashiqit, i cili hedh idenë për një strategji të re të serbëve në raport me "Arnautët"! Ai apelon në korrigjimin e qasjes nacionale serbe ndaj shqiptarëve, duke nënvizuar se si serbët, me dëbimin e shqiptarëve, humbën një "aleat" të fuqishëm të mbrojtës së tokave serbe! Me qëllim që pikëpamjet nacionale serbe të jenë sa më të qarta duhet që të kihet një kujdes më i madh në raportet serbo-arnaute, "duke kërkuar mënyra dhe rrugë që Arnautët të vihen në shërbim të idesë nacionale sere"! Obligim parësor i serbëve, sipas Pashiqit, duhet të jetë që para Evropës të dëshmohet se populli serb është gjallë i interesuar që t'i ndihmojë shqiptarët në zhvillimin e tyre kulturor duke i bindur në atë se, shpëtimi i tyre është vetëm nën kupolën e rilindjes evropiane. Dhe kjo, sipas Nikolla Pashiqit, do të arrihej vetëm përmes angazhimit të strukturave politike serbe në zbutjen e vëllavrasjes fisnore e familjare te shqiptarët si dhe duke ua shtuar besimin se vetëm në bashkëjetesë me serbët, Arnautët mund t'i ruajnë viset si dhe gjuhën e vet, dhe të sigurohen plotësisht se Serbia është e gatshme t'u garantojë autonomi në zonat e tyre fisnore! Përmbytja e letërës së Nikolla Pashiqit është kjo: "Me qëllim që pikëpamjet nacionale serbe të jenë sa më të qarta duhet që të kihet një kujdes më i madh në raportet serbo-arnaute, duke kërkuar mënyra dhe rrugë që Arnautët të vihen në shërbim të idesë nacionale serbe. Politika nacionale serbe ka bërë një gabim jashtëzakonisht të madh që, gjatë çlirimit të tokave tona të reja i detyroi Arnautët që të shpërngulen dhe, me këtë, e ndërpreu një lidhje natyrore dhe shumë të favorshme në mes të Shtetit Serb dhe popullit Arnaut duke i shndërruar ata në armiq të pikëpamjeve nacionale serb! Me qëllim që, në njërin anë të përmirësohet ky gabim dhe, në anën tjetër të sigurohet një angazhim i përbashkët në mbrojtjen e tokave të banuara me Serbë dhe Arnautë, si dhe para evropianëve të dëshmohet se Serbët dhe Arnautët mund të jetojnë së bashku njëri pranë tjetrit, kurse Serbët janë gjallë të interesuar që ta ndihmojnë zhvillimin nacional dhe kulturor të Arnautëve dhe me këtë t'i orientojnë kah vatrat e rilindjes evropiane – është e patjetërsueshme që fillimisht të përgatiten në një vatrë arsimore ku do të mësonin mbi tokat serbo-arnaute si dhe

ku do ta zbusnin hakmarrjen fisnore e familjare. Kjo do t'i mbushte plotë me besim se vetëm në marrëveshje dhe në harmoni me serbët mund t'i ruajnë viset si dhe gjuhën e tyre, ndërsa serbët janë plotësisht të gatshëm t'ua garantojnë një autonomi në zonat e tyre fisnore, e cila, në kuadër të shtetit serb mund të zhvillohej gjithnjë në të mirë të vëllazërisë serbo-arnaute"! (Koncept. AS, MID, PO, 1095, nr. 2601, F-I, D-IV) Çka flet ky dokument sot! A nuk është një "koncept-ide" mbi të cilën do të pasojnë të gjitha përpjekjet dhe strategjitë nacionale serbe, përgjatë një shekulli, që ta nënshtrojnë popullin shqiptar dhe atë ta vënë në shërbim të "mendimeve nacionale serbe"! A mos është "Ballkani i Hapur" një përpjekje e tërthortë e neopashiqëve që t'i detyrojnë shqiptarët vullnetarisht të punojnë mbi konceptet nacionale serbe të hartuara këtu e më shumë se një shekull më parë! "Ballkanin e Hapur", ndonëse është projekt serb, "nuk e dëshirojnë serbët" por e kërkon Evropa Sot në Shqipëri ka plotë "kulturologë" që mendojnë se pa një bashkëpunim intensiv të kulturëbërësve serbo-shqiptar, vështirë se do të hidhej ndonjë hap më i madh në sendërtimin e projektit "Ballkan i Hapur", ndërsa kjo do të thoshte "distanca e pakalueshme" e popullit shqiptar për në Evropë. Pra, pa një dëshmi se është e mundshme bashkëjetesa dhe harmonia serbo-shqiptare, duke u dëshmuar kjo përmes kontributit serb në zhvillimin kulturor të shqiptarëve të cilët duhet të përqafojnë idetë nacionale serbe, Serbia nuk do të na ndihmojë që të kyçemi në Evropë! Shqiptarët bëjnë mirë që herë pas herë, sa për vete, po zbulojnë dhe publikojnë strategji, ide dhe vizione serbe se si t'i përdorin shqiptarët për jetësimin e pikëpamjeve nacionale serbe. Po a kanë shqiptarët ndonjë koncept-ide, ndonjë dokument nacional të përjetshëm, i cili do të shërbente si Libër i Shenjtë kombëtar nga i cili nuk guxon të ketë shkarje asnjë milimetër! Vetëm një dokument që do të dëshmonte për zhvillim kulturor kombëtar i cili do t'i zhbente të gjitha ato koncepte serbe për zhvillim kulturor me "autonomi të plotë në zonat fisnore"?! Kështu si po na shkojnë punët, mund të na ndodhë që problemet brenda shqiptare të marrin po ato përmasa historike që i kanë sot populli maqedonas dhe ai bullgar!

Dikur dhe sot

POLITIKA DHE KULTURA

Kultura s'ka të bëjë aspak as me Parlamentin as me Qeverinë. Qëllimi i saj nuk është të fitojë shumicën në Parlament dhe të formojë Qeverinë

Branko MERXHANI

Ç'ndryshim ka midis nocioneve të Politikës dhe të Kulturës? Ç'është Politika? Ç'është kultura? Dhe sidomos ç'është thënë të merresh me kulturë pa bërë politikë? (...) (...) Çdo shoqëri çfaq dy farë vullnetesh sociale. E para është Kultura, e dyta

është Politika. Kultura përmbledh të gjitha përpjekjet teorike dhe përshpjetet spirituale ose materialiste të një Shoqërie. Kurse Politika përmban dhe përmbledh të gjitha mundimet praktike që bën një grup shoqëror brenda rrokullimeve të historisë së vet. Puna e Kulturës, në parim, është një punë mendimi, që ecën krye-

sisht drejt zbulimit të së Vërtetës. Politika, në parim, është edhe kjo një punë mendimi, por një punë që nuk ka si qëllim kryesor të gjejë të vërtetën; Politika ecën drejt për drejt për në Fuqi dhe për në Pushtet. Roli i një njeriu të Kulturës kufizohet në gjurmimin dhe përhapjen e së Vërtetës. Mendimtari përpiqet të

përhapë mendimet e veta dhe t'i futë në vetëdijen e bashk atdhetarëve të tij. Mendimtari s ka nevojë të vërë në dorë fuqin reale dhe të sundojë botën duke u mbështetur në bajonetën e xhandarit. Ai ndjek rrugën e vet. Dhe ndjek këtë rrugë me guxim dhe me qetësi. Ai ecën edhe duke vuajtur. Roli i një njeriu të Politikës është krejt


i ndryshëm. Politikë d.m.th. sundim. Dhe asgjë tjetër. Qëllimi i një njeriu të Politikës, natyrisht kur ky është një njeri i urtë dhe i sinqertë, është një qëllim i lartë që ka një kuptim historik. Politikani përpiqet të qërojë jetën shoqërore nga zakonet e këqija, nga veset, dhe në vëndin e tyre të vendosë të mirat. Prandaj Politikani ka nevojë të domosdoshme të vërë në dorë fuqinë e sundimit dhe të zotërojë, pa asnjë kufizim, të gjitha zotësit vepronjëse të një vëndi. (...) Artistët, Moralistët dhe Filozofët janë vetëm Mendimtarë. Këta i propozojnë popullit ndjenjat dhe mendimet e tyre: Vetëm i propozojnë. Nuk mund t ia imponojnë. (...) Kultura s ka të bëjë aspak as me Parlamentin as me Qeverinë. Qëllimi i saj nuk është të

fitojë shumicën në Parlament dhe të formojë Qeverinë. Kultura, që t i bëjë të pranueshme bukuritë që ndjen, të mirat që jep shëmbull dhe mendimet që shfaq, nuk kërkon ndihmën e organeve zyrtare. Kultura veprat e veta i vleftëson ndryshe. Ka në dorë një tok mjetesh morale. Ka b.f. bindjen, shijën, entuziazmën dhe një sëri mënyrash të tjera veprimi. Që të mësohet përmënc një vjershë e bukur, s ka nevojë që të votohet një dekret-ligjë. Gjithashtu asnjë ligjë nuk mund t a ndalojë këndimin e një libri. Bilë është vënë re se librat e ndaluara kërkohen dhe këndohen më tepër. (...)Një sundimtar mund t imponohet edhe për hirë të violencës. Kurse një mendimtar thjeshtë nuk pëlqehet ose simpa-

thizohet. Autoriteti që ky gëzon mbi një pjesë të popullit, nuk është një autoritet relativ. Është një autoritet personal. S ka të bëjë me pozitën e vet. Ka të bëjë vetëm me personin e vet. Një e vërtetë shkencore, një veprë artistike, një meritë morale, nuk humbet asgjë nga vlera e saj kur nuk çmohet nga ana e zyrtarëve ose edhe kur gjen mospërfilljen e tyre. Vulat e zyrrave nuk janë dokumenta kulturore. Janë vetëm akte administrative dhe gjyqsore. Me këto vula vihen në litar edhe të dënuarit dhe lartësohen edhe zotërinjt e ndershëm. ***

Siç e kemi shpjeguar gjer këtu me një mënyrë krejt të hapët dhe pothuaj popullore, Politika dhe Kultura janë dy farë veprimtarish krejt

të ndara dhe të veçuara njera nga tjetra. Janë të veçuara në përmbajtje dhe të ndara në qëllime. Kombet që dinë mirë të ndajnë njerën nga tjetra këto dy farë veprimtarie shoqërore, përparojnë dhe lartësojnë hem organizmën e jetës së tyre politike, hem organizmën e jetës së tyre kulturore. Përkundrazi ku këto dy gjëra trazohen midis tyre, atje Kultura bëhet skllavi i Politikës dhe humbet kuptimin e qënies së vet; dhe nga ana tjetër edhe Politika fshin dhe çvleftëson çdo lloj përpjekje që ka si qëllim të ndihmojë Shoqërin në ecjen e sajë drejt përparimit dhe qytetërimit. Dhe kështu shkatërrohen dhe degjenerohen të gjitha. Politikani mbetet pa dritë. Intelektuali bëhet dallkauk. (...) (1936)



Intervistë më Agim Bajramin, poet

ENDE MBISUNDON MENDËSIA PROVINCIALE

Antologjia e përbashkët poetike dhe ajo e prozës së shkurtër nuk ekziston akoma, ndërsa ngjarjet dhe aktivitetet e përbashkëta mes krijuesve të tre shteteve janë me pikatore. Gjithkush shpreson që këtë punë ta bëjë dikush, duke mbetur sot dhe kësaj dite në pritje të Godosë

Shkëlzen HALIMI

Agim Bajrami është poet me origjinë çame. Ka lindur në Cërrik të Elbasanit në mesin e vitit 1959, ndërsa shumë vite më pas u shpërngul në Durrës. Ka ndjekur studimet në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", dega gjuhë dhe letërsi shqipe. Është autor i shumë librave me poezi, ndër të cilat: "Romancat e muzgut", "Arratisje pulëbardhe", "Kohë që s'dashuron", "Mbrëmje të puthura", "Ylbere pa lamtumirë", "Pëshpërimë", "Sërisht", "Megjithatë" etj. Është fitues i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

HEJZA: Larg atdheut, larg vlerave kulturorPse edhe më tej po i mungon ai identiteti i plotë Letërsisë Shqiptare! Fenomenet kulturore (nga lëmi i gjuhës, traditës, folklorit, trashëgimisë materiale e shpirtërore etj.), të cilat zhvillohen përtej standardeve akademike e politike, megjithatë studiohen dhe përfshihen si vlera të padiskutueshme në materiet studiuuese antropologjike! Letërsia gojore trajtohet si vlerë e jashtëzakonshme kulturore. Letërsia Shqiptare – kush po përpiqet që "letërsi shqiptare" ta përkufizojë vetëm atë që krijohet në Shqipërinë administrative! Po ajo që

krijohet në Kosovë, në Maqedoninë Veriut dhe në viset etnike shqiptare? Në cilën letërsi të përfshihet krijimtarialetrareeshkrimtarëshqiptarë që jetojnë në diasporë, nëpër botë?

A. BAJRAMI: Me termin letërsi kombëtare, shumë kush nënkupton letërsinë e shkruar nga autorë shqiptarë në gjuhën shqip. Mendoj se ky nuk është specifikimi më i mirë dhe më i gjetur për të. Letërsi kombëtare konsiderohet letërsia që shkruhet në gjuhën amtare dhe që di të trajtojë me thellësi dhe intuitë historinë e kombit që i përket, që nga gjeneza gjer në ditët e sotme, që di të pasqyrojë thellësisht dhe të ngrëjë në art shpirtin e pavdekshëm dhe rrugëtimin në kohë të kombit të vet. Nëse do t'ia përshtatja disa vargje të Podrimjes nga poezia "Jam biri yt Kosovë", letërsia kombëtare është ajo që ka ditur të trajtojë me gjuhën e saj superiore "dëshirat e heshtura, vuajtjet, gëzimet dhe vdekjet e kombit, lindjet e bardha dhe caqet e kallura". Për më tepër, është hallka, që di të bëjë lidhjet mes të shkuarës dhe së sotmes, duke parë më qartë se të tjerët me syrin e saj vizionar të ardhmen. Letërsia e një kombi është e tillë, që po ta shtrydhësh, në vend të germave duhet të kullojë etnosin

pastër. Homeri, Eskili, Tolstoi, Çehovi, Dostojevski, Balzaku dhe Hygoi ishin dhe vijojnë të mbeten të adhuruar për bashkëkombësit e tyre, pikërisht ngaqë ditën të ngrinin në art dhe pasqyronin me madhështi, disa nga momentet më kulmore të historisë të kombeve të tyre. Letërsia jonë gjithashtu mund të krenohet me Fishtën, Mjeden, Esad Mekulin, Mitrush Kutelin apo Lasgush Poradecin, për të vazhduar më tej me më të rinjtë Kadare, Kongolli, Agolli, Ali Podrimja, Azem Shkrelin, Teki Dervishin, Adem Demaçin etj. Se sa kombëtare është letërsia që shkruhet sot, është çështje që hap diskutime, dhe meriton studime të thelluara nga studiues të fushës. Megjithatë, ajo që vlen të theksohet se e dallon atë nga ajo e vendeve të tjera, është prirja e përhershme për të pasur si lajtmotiv qendror përpjekjet tona mbinjerëzore për mbijetesë dhe identifikimin e kodit të saj. Është kjo arsyeja që në shumicën e veprave të Zija Çelës, Skender Drinit, Agron Tufës, Bashkim Hoxhës, Besnik Mustafajt, Ag Apollonit, Jusuf Buxhovit e gjen të pranishëm këtë kod herë në trajtë reminishencash etnopsi dhe herë të tjera në frymë aktuale epiciteti. Janë vepra që tërheqin vëmendjen sa për stilin e tyre të

veçantë aq dhe për shënjimet dhe frymën e tyre të thellë kombëtare.

HEJZA: A kemi sot një standard sipas të cilit shkrimtarët shqiptarë dhe krijimtaria e tyre letrare, pavarësisht ku jetojnë dhe ku krijojnë, do të përbënin Letërsinë Shqiptare të periudhave të ndryshme? Bazuar në "antologjitë" e sotme, që po na mbijnë si kërpudhat pas shiut, po dëshmojmë se më tepër gjakojmë kah "krijimtaria letrare e mëhallëve" sesa kah krijimtaria letrare kombëtare!

A. BAJRAMI: Për fat të keq edhe përkundër iniciativave dhe dëshirave të mira, për të pasur një standard të unifikuar letrar, letërsitë që krijohen këtej dhe përtej kufijve shtetërorë, vazhdojnë të zhvillohen dhe promovohen ende sipas modeleve dhe mënyrës së tyre të vjetër, të ndara si gjithmonë nga njëra tjetra si me thikë. Ende dhe sot institucionet përgjegjëse të shteteve përkatëse, nuk kanë asnjë lloj strategjie për këtë çështje. Krijuesit shqiptarë vijojnë të takohen me njëri tjetrin vetëm në ndonjë promovim libri, ose nëpër panairë në Tirane dhe Prishtinë, në të cilët për hir të së vërtetës, më tepër se anës letrare, i mëshohet biznesit dhe fitimit të botuesve përkatës.



Edhe pse krijimtaritë letrare janë punë individuale, nuk do të thotë që ata të mos ndodhen herë pas here në tryeza të përbashkëta diskutimesh dhe rrahje idesh për problematika dhe çështje që lidhën frymën dhe identitetin kombëtar të letërsisë sonë. Edhe pse ka dekada që kufijtë janë hapur dhe barrierat ideologjike kanë rënë, mendësitë provinciale dhe logjika mëhallës, siç thoniedheju, është ende mbisunduese tek ata që drejtojnë fatet dhe politikën tona kulturore. Antologjia e përbashkët poetike dhe ajo e prozës së shkurtër nuk ekziston akoma, ndërsa ngjarjet dhe aktivitetet e përbashkëta mes krijuesve të tre shteteve janë me pikatore. Gjithkush shpreson që këtë punë ta bëjë dikush, duke mbetur sot dhe kësaj dite në pritje të Godosë, thua se procesi i unifikimit qenka si dhuratat e vitit të ri, që gjyshi Santa Klaus, do t'ua hedhë fëmijëve nga oxhaku. Kemi të bëjmë kështu me një indiferencë dhe mendjengushtësi vrasëse, që sot e 30 vite po i kushton rëndë gjithë ambientit tonë letrar, pasi është fiziologjike, që letërsia e një kombi të veprojë e të zhvillohet si një organizëm i vetëm unik, larg shkërmoqjeve dhe ndasive krahinore. Logjika e çalë, ne dhe ata, që mbisundon akoma në mendjet e shumë prej nesh, kaq fyes dhe bullizues, dashje pa dashje, e pengon zhvillimin e kësaj letërsie dhe dashje pa dashje çon ujë në mullirin e atyre që duan të na shohim të vegjël dhe të përçarë. Edhe pse ka kohë që përflitet për zhvillimin e një konkursi kombëtar letrar, që do t'i vinte në lëvizje krijuesit shqiptarë dhe do të evidentonte shumë emra dhe prirje letrare, gjithçka ka mbetur në kufijtë e dëshirave individuale. Po kështu do të ishte e mirëpritur edhe hapja e një

gazete ose revistë letrare kombëtare, ku të trajtoheshin problemet aktuale të çetërsisë dhe artit siç e kanë gjithë vendet e tjera përreth nesh.

HEJZA: Fatkeqësisht, këtë problem tashmë e kemi të institucionalizuar! Nëpër librat e leximit të niveleve të ndryshme në shkollat e Shqipërisë nuk përfshihen (ose fare simbolikisht) krijues nga Kosova e nga viset e tjera etnike. Janë me dhjetëra krijues të huaj, por jo edhe ata krijues shqiptarë që jetojnë dhe krijojnë jashtë shtetit administrativ shqiptar! Librat e leximit mund të bëhen model i bashkimit kulturor të shqiptarëve që do të mund të kopohej edhe në teatër, në galeri, në opera, në balet, në ansamble etj.

A.BAJRAMI: Është një pyetje që paradoksi shqiptar as që ka ndërmend t'i kthejë përgjigje. Mungesa e një strategjie unifikuese ka kohë që po jep frytet e saj të hidhura dhe te helmuara edhe në tekstet shkollore. Lexuesit e vegjël dhe të rinj të Shqipërisë londineze, i njohin pak ose aspak shkrimtarët e Kosovës, ata me kombësi shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe me pak krijuesit e diasporës. Kur isha i vogël më ra në dorë vepra e Hivzi Sulejmanit, "Fëmijët e lumit tim", të cilin s'më bëhej ta lëshoja nga dora. Ishte një roman me pak fletë, por nëpërmjet tij një kuptova se përtej gjithë asaj që na mësohej në shkollë, kishte edhe një pjesë tjetër atdheu me emrin Kosovë, që dikush mendohej të na e fshihte. Mjaftoi vetëm ai libër që unë të njoh dhe të dashurohem me Kosovën dhe njerëzit e saj në distancë. Jam shumë i sigurt se ndjesi te tilla, ashtu si unë, kanë provuar me mijëra e mijëra

moshatarë të mi te atij brezi. Sepse libri është dhe do të mbetet një magji e lëvizshme, do të thoshte me te drejtë Stephen King. Është ai dhe vetëm ai që di të mbjellë brenda teje farën e kulturës dhe dashurisë. Letërsia e mirë dhe arti lidhin kombet që ndodhen në kontinente të largët, jo më pjesëtarët e një kombi dhe një gjaku si jemi ne. Ndaj është imediate të fillojnë t'i ndryshojmë gjërat dhe t'i fusim në hullitë e duhura. Futja e letërsisë sonë më të mirë nëpër tekstet mësimore është një domosdoshmëri e kohës, sepse konceptet bazë të dashurisë për familjen dhe shoqërinë mund të krijojnë vetë nëpërmjet leximeve. Është e pafalshme që në Tiranë, Shkup dhe Prishtinë, të gjesh masivisht nxënës me njohuri mjerane për shkrimtarët e kombit të tyre, nxënës që përveç Naim Frashërit, Fishtës ose Kadarese, të mos kenë lexuar asnjë varg tjetër nga poetët dhe shkrimtarët e tjerë të mëdhenj të kësaj fushe. Nëse në tekstet e shkollave tona në Shqipëri mungojnë poezitë e Agim Devës, Qerim Ujkanit, Gani Xhafollit etj., në tekstet e shkollave të Maqedonisë së Veriut dhe në Kosovë emrat e Odise Grillos, Bedri Dedjas, Adelina Mamaqit, Tasim Gjokutajt, janë krejt të panjohur. Në vend të emrave që sapo përmendëm, fëmijët tanë bombardohen me lloj-lloj autori nga letërsitë e huaja, pjesa më e madhe e të cilëve janë anonimë edhe në letërsitë e vendeve të tyre. Më ka rënë rasti të lexoj disa prej tyre, në një nga librat e leximit të klasës së gjashtë dhe kam vënë duart në kokë. Gjuha aspak e përshtatshme për t'u kuptuar dhe asimiluar nga një fëmijë, dhe mbi të gjitha një përmbajtje shumë hermetike, që jo vetëm i largojnë ata

nga letërsia, por i bëjnë ata edhe me dhimbje koke. Sot letërsia për fëmijët ka mbetur mes katër rrugëve. Do ishte mirë ngritja e një redaksie të përbashkët me poetë, shkrimtarë dhe kritikë të kësaj fushe dhe themelimi i një reviste për fëmijë.

HEJZA: Historia e letërsisë shqiptare, apo letërsia bashkëkohore shqiptare, që paraqet gjeografinë letrare të mëhallëve e të rajoneve, përimitson letërsinë shqiptare si vlerë gjithëkombëtare, deri në pjesë të gjymtyrëve të trungut kombëtar, deri në copëza papërfshirjen e plotë të cilëve nuk do të na paraqitet mozai-ku i identitetit tonë letrar e kulturor!

A.BAJRAMI: Nuk mund të flitet për letërsi kombëtare dhe unifikim, nëse vazhdojmë akoma me parcelizime dhe mure ndarëse. E kam theksuar këtë edhe në një intervistë tjetër diku: Letërsia kombëtare si pjesë përbërëse e kulturës shpirtërore të një kombi, nuk mund të konceptohet si e tillë, pa qenë një trup i vetëm. Ajo krijohet nga letërsitë e mëhallëve, siç thoni ju dhe rajoneve të ndryshme, ku flitet, mendohet, qeshet dhe qahet shqip, ku banojnë dhe krijojnë shqiptarët. Larushitë tematike dhe stilistikore, jo vetëm e zhvillojnë dhe e pasurojnë atë, por e bëjnë më gjithëpërfshirëse dhe më solide njëherësh. Bibliotekat tona do të ndiheshin të varfra nëse pranë "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur", nuk do të gjendeshin "Gjarpërinjtë e gjakut", "Sheshi i unazës", apo "Koha e dhive", "Lum Lumi" apo "Poemën e Kosovës". Janë vepra që krijojnë isopolifoninë e duhur të romanit dhe poezisë sonë, të cilat japin e marrin natyrshme me njeri tjetrin, si pjesë organike të së tërës.



Bima e butë e letërsisë shqipe u zhvillua me vështirësi në një tokë shkëmbore, do të shkruante Robert Elsie, dhe shumë herë ekzistenca e saj u vu në rrezik nga faktorë të jashtëm. Në rastin konkret, ekzistenca e kësaj letërsie po vihet në rrezik, jo nga fajtorë të jashtëm, por nga paaftësia dhe xhelozia jonë karakteristike ndaj njeri tjetrit, nga individualizmi i sëmurë dhe prirja e unit. Nëse do të vazhdojmë me këtë mendësi, askush të mos presë progres, risi dhe aftësi konkurruese me letërsinë e vendeve të tjera.

HEJZA: A guxojmë të lejojmë edhe më tej që gjeografia etnike të na i pengojë themelimet, ngritjet dhe funksionimet e institucioneve kombëtare kulturore! Në rastin konkret, pse na mungon një shoqatë e shkrimtarëve kombëtar, me kritere të qarta e strikte mbi atë se kush do të mund të kyçej në këtë "pararojë" të identitetit tonë letrar?

A. BAJRAMI: Institucionet që drejtojnë kulturën në kuadër të së cilës është edhe letërsia, ngrihen për t'i dhënë më shumë jetë dhe vizion krijimtarisë së autorëve të vendeve të tyre dhe jo për t'iu vënë gurë nën rrota. Fatkeqësisht, përvoja e këtij tridhjetëvjeçari ka qenë tepër e hidhur për njerëzit e letrave. Shkatërimi i Lidhjes së shkrimtarëve si institucioni i vetëm bazik, që do të udhëhiqte veprimtarinë promovuese dhe do të bëhej një urë lidhëse për bashkimin e të gjithë krijuesve të një gjuhe dhe gjaku, la pasoja të rënda dhe të pariparueshme. Më pas të gjithë e dimë se si përfunduan gjërat. Drejtorja e librit pranë Ministrisë së Kulturës nuk është e aftë të operojë dhe zgjidhë morinë e halleve dhe problematikave të krijuesve tanë, Shumë shumë ajo mund të organizojë ndonjë promovim autorësh ose ndonjë ekspozitë fotografike. Të vetmen gjë që ia vlen të "kujtos" është ekspozita fotografike e parcelizuar e shkrimtarëve dhe poetëve, e cila ngjalli mjaft kundërshti dhe revolte të krijuesit. Pa projekte afatgjata dhe pa strategji, kontributi i saj as ia vlen të përmendet, ndaj dhe krijuesit nuk besojnë aspak në ekzistencën dhe kontributet e saj.

HEJZA: Shkrimtar i lindur dhe shkrimtar akademik! I pari jep për popullin, për të dytin jep populli! A i kemi në këta dy tipe shkrimtarësh, apo fërkimet politiko-ideologjike kanë sjellë të kemi shkrimtarë të pushtetit dhe shkrimtarë prej pushtetit! A është kjo dukuri problemi që na mungojnë pasardhës të denjë të linjës krijuese të shkrimtarëve gjenialë që i patëm apo që i kemi akoma?

A. BAJRAMI: Në kushtet ku ndodhen shoqëritë tona të varfra, termi shkrimtar akademik nënkupton përgjithësisht ata shkrimtarë që i jargaviten pushtetit dhe pushtetarëve të ngjyrave të ndryshme, ata shkrimtarë që e ngjyrosin në ngjyrë rozë realitetin tonë të shqetësuar, që mbyllin të dy sytë dhe të dy veshët, përparaplagëve të rënda të shoqërisë sonë, për benefitet dhe interesat e tyre. Nëse dje ishin të përkëdhelurit e pushtetit, sot janë përsëri të preferuarit e shtëpive botuese, të televizioneve dhe organeve letrare më në zë. Janë të përhershmit që marrin çmi-

met kombëtare dhe ato të panairëve, si dhe çdo honorar tjetër. Individë të tillë edhe përkundrejt talentit dhe vlerave artistike, me konformizmin dhe jargavitjet e tyre i kanë sjellë një dëm të madh letërsisë dhe kulturës sonë, sepse janë mjeshtër të mbytyjes se zemrave ndryshe dhe frymës protestuese. Shkrimtari i vërtetë është krejt ndryshe nga ta, ai është një individ i ndjeshëm dhe i pamanipulueshëm, shqetësohet për shoqërinë dhe fatet e kombit, dhe unifikohet me të. Antikonformizmi dhe kontradikta e përditshme me të gjithë pushtetet është në tiparet e tij. Shkrimtarët e popullit mbeten vetvetja dhe nuk presin donacione dhe benefite nga shteti. Si skllëvër të pasionit dhe dashurisë për letërsinë, angazhimi i tyre intelektual ju ha një pjesë të mirë të kohës, ndonëse janë të ndërgjegjshëm se askush nuk do t'i vlerësojë. E konsiderojnë të shenjtë letërsinë dhe sakrifikojnë edhe lekëte fundit të pensionit, apo edhe lekët që kanë vënë nënjanë për shpenzimet e varrimit të tyre, përbotimin e librave. Unë kam njohur shumë prej tyre dhe më ka mahnitur kjo lloj sakrifice. Ata duket se jetojnë vetëm për lexuesit dhe lumturohen kur i dhurojnë atij libra cilësorë. Njerëz të tillë reflektojnë vetëm virtyte dhe meritojnë t'iu ngresh kapelën dhe t'iu adhurosh.

HEJZA: Sa njihen shkrimtarët tanë në mes vete dhe sa i njeh opinioni ynë? A mjafton ajo pak njohje që vjen përmes informatare të thata mediale? Pse mungojnë kritika, studimi letrar, takime me krijuesit, çaste dedikuar krijuesve? Si të joshet ai një grusht lexuesish që na ka ngelur!

A. BAJRAMI: Shembja e kufijve shqiptaro - shqiptar solli një klimë të re në drejtim të forcimit të lidhjeve dhe marrëdhënive mes komunitetit të shkrimtareve dhe poetëve të një gjuhe dhe gjaku, por që jetonin të ndarë në tre shtete të ndryshëm. Kjo gjë krijoi mundësitë që ata të njiheshin më nga afër me njëri tjetrin, të shkëmbenin mes njëri tjetrit veprat dhe përvojat krijuese, të organizojnë aktivitete promovuese etj. Vetëm se kaq është pak, shumë pak. Ky është vetëm fillimi i fillimit. Ka ende boshllëqe të tmerrshme procesi i njohjes mes nesh mbas një ndarje kaq të gjatë, sidomos lexuesit. Ata i njohin shumë pak shkrimtarët përtej kufijve. Kjo ka sjellë që sa herë organizohen panairë libri, ata rrallë herë kthejnë kokën nga stenda e autorëve nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Të jeni të sigurt që nuk e bëjnë këtë nga menefregizmi, ose përbuzja, jo. Është thjeshtë nga mungesa e njohjes, pasi ne pak kemi bërë për të fshirë nga mendja e njerëzve muret e vjetër të ndarjeve. Papërgjegjshmëria e politikës shqiptare vazhdon të refuzojë në heshtje dhe mos të institucionalizojë çdo ide dhe platformë bashkimi. Demagogjia e fjalimeve dhe buzëqeshjeve janë investimi i tyre i vetëm në këtë fushë. Edhe organizimi i ndonjë aktiviteti sa për të thënë, ku krijuesit heqin të zezat e ullirit për të marrë pjesë, me shpenzimet dhe përpjekjet e tyre lë për të dëshiruar në çdo drejtim. Në organizimet e rralla akademike, vetëm në raste jubilarë të ftuarit janë po ata fytyra që kanë qenë që nga kohët që s' mbahen mend, sot e kaq vjet. Diskutohen po ato gjëra, ku njeri i bie gozhdës dhe tjetri patkoit dhe

mirupafshim. Fenomene të tilla janë fyese dhe poshtëruese për procesin e unifikimit, por edhe një thirrje që krijuesit e rinj ta marrin vete situatën në dorë. Dhe diçka ka nisur të lëvizë. Organizimi këto vitet e fundit me një format të ri i REPUBLIKËS nën dirijimin e Vlora Ademit apo FESTIVALI POETIK i Prishtinës me moderimin e Donika Dabishevcit, kanë sjellë një fillad të ri në klimën tonë letrare. Shpresojmë të vazhdojnë sa më gjatë në këtë rrugë të bukur dhe të shmanjgen sa të jetë e munduar përzgjedhjet personale apo ndërhyrjet klaronore, duke bërë pjesë të tyre krijues të vërtetë dhe të rinj me perspektivë.

HEJZA: Çka humb Shqipëria apo edhe Kosova, nëse herë pas here do të subvenciononin krijime të krijuesve shqiptar të mirëfilltë nga viset etnike apo edhe nga diaspora. Pse në ministrinë gjegjëse të këtyre dy shteteve nuk ka thirrje për subvencionimin e veprave origjinale si prurje nga komuniteti krijues nga hapësirat e tjera etnike, por dhe nga diaspora?

A. BAJRAMI: Asnjë shtet apo shoqëri e përgjegjshme, nuk humbet nga sponsorizimi i librave dhe veprave të autorëve të tyre më me vlerë. Përkundrazi, ai fiton shumë në disa aspekte. Në vendet e zhvilluara ku libri nderohet dhe lexohet, edhe në sheshe publike dhe metro shkrimtari dhe poeti konsiderohen si asete kombëtare nga shteti dhe shoqëria. Janë ata që me politikën dhe strategjitë e tyre mbështetëse luajnë rolin e protektorit, duke iu gjendur atij në krahë në çdo rast. Në Maqedoni dhe Kosovë, situata, me sa di unë, është pak më ndryshe nga në shtetet tona, ku investimet për artet dhe letërsinë janë në kuota qesharake. Edhe kur aprovohet ndonjë fond, atë dihet që do ta marrin miqtë dhe tarafet që ngjisin e zbrasin shkallët e Ministrisë së Kulturës. Në Shqipëri përpjekja për të siguruar ndonjë sponsorizim për botime libri apo ngjarje letrare kombëtar është e dështuar që në embrion.

HEJZA: Pa dyshim është nevojë urgjente hartimi i strategjive, i programeve kombëtare që të shtohet interesimi për lexim. Po kaq e domosdoshme është edhe nevoja për përkrahjen e krijimtarisë për fëmijë, për krijimin e redaksive profesionale e mbase edhe të licencuara për përkthim të letërsisë së huaj. Gjithsesi, tërë ky interesim do të ngelte i gjallë vetëm nëse do të ngritnim shkollat të kritikëve të rinj letrar nën mentorimin e atyre pak kritikëve që i kemi akoma gjallë!

A. BAJRAMI: Pikerisht këtu qëndron e keqja. Asnjë nga shtetet tona nuk ka një strategji të qartë për këtë çështje madhore dhe mendoj se do të duhet kohë ta bëjnë këtë. Tranzicionet e stërzgatur, dashur pa dashur, e kanë penguar zbatimin e kësaj strategjie në terren, kam parasysh këtu shkollat. Edhe përkundet iniciativave personale dhe punës që bëjnë mësuesit, leximi i librit lë për të dëshiruar. Jam dakord me mendimin e disave që e justifikojnë këtë me epokën digjitale, por jo të shkohet gjer në abandonim. Kjo është një situatë delikate që mund të agravohet nëse nuk ndërhyhet menjëherë. Duhet të dalim nga rutina e standardeve të dikurshëm për të parë përpara. Institucio-

net përkatëse duhet t'i shqetësojë një fenomen i tillë dhe duhet të gjejnë mënyra dhe forma sa më efektive për ta vënë këtë punë mbi baza të shëndosha dhe për ta kthyer lexuesin përsëri pranë librit. Ideja për krijimin e shkollës së kritikëve të rinj më duket interesante dhe me vend.

HEJZA: Psemungon prezantimi i krijimtarisë sonë letrare bashkëkohore për lexues të huaj! Nuk kemi çfarë t'u ofrojmë apo institucionet tona nacionale e shtetërore mendojnë që diplomacia politike është e mjaftueshme në prezantimin tonë para botës?

A. BAJRAMI: Unë mendoj se ne kemi ç't'u ofrojmë lexuesve dhe shtëpive botuese perëndimore dhe lindore, gjithmonë brenda kufijve të modestisë, Përveç Kadaresë që vazhdon të jetë prezent në shijet e lexuesve dhe nëpër libraritë më të mëdha të Francës, Gjermanisë dhe shumë vendeve të tjera, rrugën për të lexuesi i huaj kanë nisur ta gjejnë suksesshëm edhe romanet e Besnik Mustafajt, Visar Zhstit, Mira Meksit, Zija Çelës, Bashkim Hoxhës, Thanas Medit, Bashkim Shehut, Luan Ramës, pa përfshirë këtu Gëzim Haxhdarin, Shpendi Sallakun (Noen) që jetojnë dhe krijojnë prej dekadash në ato vende dhe janë vlerësuar edhe me çmime të rëndësishme atje. Një bum botimesh këto kohë të fundit po njihet edhe krijimtaria e Namik Dokles, me romanet dhe dramën e tij në Spanjë, Bosnje Hercegovinë etj. Kështu po ngjet edhe me poetin e njohur që jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjekë Marinaj, me Petraq Riston, Luljeta Lleshanakun, për natyrën dhe vlerat stilistikore të të cilëve është shkruar shumë. Ky është një grup i mirë autorësh, vlerat artistike të të cilëve, në një fare mase po evidentojnë edhe vlerat reale të letërsisë sonë. E, megjithatë, po ta shohim me kujdes, ngjarje të tilla me përmasa kombëtare, nuk lidhen aspak me përpjekjet e organizmave tona shtetërore që paguhet për këtë, por thjesht me iniciativat dhe përpjekjet individuale të autorëve në fjalë. Përkundër indiferentizmit të institucioneve shtetërore, mbyllur si gjithmonë në kullat e tyre burokratike, janë ata vetë që janë rropatur për të gjetur përkthyesit, redaktorët dhe shtëpitë e huaja botuese. Janë po ata që shpenzojnë për të promovuar veprën e tyre nëpër panairët e ndryshëm ndërkombëtar. Të kesh në krye pushtete që kulturën e kombit të tyre e konsiderojnë si apendiks, figura e poetit dhe shkrimtarit është shndërruar në vuajtjet e Sifit që ngjitet e zret malin e torturave me shkëmbin mbi shpinë.

HEJZA: Me cilët krijues të sotëm do të mburreshim nesër, siç mburrimi sot me De Radën, me Naimin, me Samiun, me Mitatin, me Nolin, me Mjedën, Asdrenin, me Fishtë, me Konicën, Kutelin, Poradecin, Pipën, me Koliqin etj.


A. BAJRAMI: Edhe pse dikush konstaton se letërsia shqiptare nuk po prodhon më emra të niveleve të Kadaresë, Arapit, Podrimjes, Rreshpjes, Shkrelit, Kongolit apo Agollit, unë vazhdoj të lexoj dhe shijoj poetë dhe poetete me një forcë të jashtëzakonshme fjale dhe mendimi. Janë

krijues që punojnë në heshtje, larg zhurmave të mediave injorante që promovojnë poetë dhe shkrimtarë mediokër nga Tirana dhe Prishtina, që nuk i ftojnë shpesh nëpër ngjarje dhe nuk i nominojnë asnjëherë ju-

ritë miope të ministrive të kulturës. Ata janë antipod me grupin e pseudopoetëve që i kanë privatizuar çmimet e përvitshëm dhe kurorat e arta të panteonit poetik, por që kur i lexon, të lenë si shije erën e një gjelle të

djegur. Personalisht jam adhures i poezisë lirike të Skender Rusit, tregimeve të shkurtra me elementi epike të Shkëlzen Halimit dhe disa prej romaneve dhe dramave të Bashkim Hoxhës, Dashnor Kokonozit, Agron

Tufës dhe Mira Meksit. Emra të tilla mendoj që i bëjnë nder letrave tona dhe do të jenë pasardhësit e denjë të emrave të nderuar që cituat ju.



Në shiritin e kohës

NATA E FUNDIT E JETËS SË NAIM FRASHËRIT

Ja ku është ky njeri i dashur! Ja ku rri shtrirë! Më vjen ta pyes si je... Shiko, po më përgjigjet... po më thotë, pas zakonit që kish, me zë t'unjët e t'ëmbëlë "prapë ashtu jam"... "Ah, ç'them unë! Ato buzë më nukë lëvizin, ata sy më s'shohin!"

Mithat FRASHËRI

O shqipëtarë, në doni të nderoni kujtimin e këtij njeriu të math që po e qansot e tërë Shqipëria, mbani mënt fjalët e tij: Jeni të mirë, vetijpastrë, doni mëmëdhenë dhe gjuhënë tuaj! Akoma s'ish zbardhëlluarë kur u hap dera; sa pa marrë përgjigje, pritnja të më thoshin të ren' e ligë: Naim beu është fare keq! – këto të pesë fjalë më dredhin mishtë. Naim beu është keq! – kishin katër vjet e gjysmë q'e qanim këtënjeritëmash; edinimqësëmundja s'i kish shpëtim! Po kujt i vente goja? E dinim, po s'donim ta besonim... E shtuna në familjen tonë është dit' e nëmurë, dit' e zezë. Ashtu u shua të shtunë në më dy orë të mëngjesit, 7 vjesht' e dytë 1900, një jetë që kish nisurë më 1 të natës duke gdhir' e hënë, më 13 të majit 1846 në Frashër. Ja ku është ky njeri i dashur! Ja ku rri shtrirë! Më vjen ta pyes si je... Shiko, po më përgjigjet... po

më thotë, pas zakonit që kish, me zë t'unjët e t'ëmbëlë "prapë ashtu jam"... "Ah, ç'them unë! Ato buzë më nukë lëvizin, ata sy më s'shohin! S'i kemi për të dëgjuarë më zënë! Kur të kemi ndonjë hall, më s'kemi kë të pyesim, s'ka kush të na japë këshilla! S'ka kush të na japë kurajo dhe shpresë! Këtu fillozofia dhe mendja s'hyjnë në punë; një tillë mynxyrë s'ka ngushullim; këtu njeriu le ç'ka mësuarë, le stërvitjenë, le mendjenë dhe bëhetë foshnjë; zemra zbulohetë nga pëlhurët' e njerëzisë dhe bëhetë siç është te foshnja, ashtu si e bëri Perëndia! Buzët janë pa zë, po zemra qan! Njerëzit e shtëpisë janë të gurrosur, vetëm lotët u rrjedhin, krahërorët po psherëtijnë! Sazi, lamikëtëfamilje! MeNaimBenë nuk humbasim një njeri të dashur, një të madhin e fëmijës, por një mësonjës, një mpronjës, një këshill-onjës, një atë! Edhe jo ne vetëm, por gjithë Shqipëria. Tërë dita, tërë nata

shkon në helm e në mejtime; s'duamë të flemë, duamë t'i rrimë pranë se... kjo është nat' e fundit! Paskëtaj syt' e trupit më s'kanë për të parë atë Naim! Vetëmmendja e kapërtë kujtuar dhe për të qarë. Një nga miqtë nxjerr nga xhepi "Lulet e verësë" dhe na thotë: Pas këtaj për ne këto fletë janë Naim; ay shkoj, vate te e vërteta, po këto mbenë! Këndon "Të vdekuritë". Në këto vjersha zemra dhe helmi na gjen njëushqim: Po vallë ku vanë? Për jet' u mërguan? Apo u ndryshuan? E djela gdihet, kjo është dit' e fundit; sot do vihetë në gji të dheut, të këtij dheu tek i cili venë gjithë njerëzit, të mir' a të liq. Sot po fshihetë për jetë nga bota fytyr' e këtij njeriu të dashur e të rrallë! Sot do lihetë të kalbetë më pak kohë ky njeri që natyra ia ka të rrallë shokët dhe s'i pjellë veçse më ca qint vjet njëherë! Shikoni këta njerëz, sa helm ka mbi fytyrë të tyre! Shihni sa janë të shumë: ka nga çdo fe, nga çdo vërsë,


e nga çdo radhë. Këta e njihnin në gjallëri: vinin e kërkonin këshilla, vinin e pyesnin për çdo punë. "I varfëre vinja te Naim beu, i pasur shkonja; i urët vinja, i nginjët shkonja, pa shpresë vinia, plot shpresë shkonja; nie shpirt të sëmure vinja, kur shkonja ndjenja vetëhenë të gjall' e me shpirt; fjalët që na thoshte na shëronin zemrën!" – thotë një ng'ata. Këta njerëz që kanë sytë me lotë, këta janë ng'ata që kanë parë të mira: kush kërkonte ndihmë, kush kish punë, kush kish djal' a çupë për në shkollë: kushdo që kërkonte ndihmë, s'kish ndihmës më të math e më të mirë se kyshqiptarimathqëpovarrohetësot! Këta të tjerë mi fytyrët e të cilëve është shkruarë helmi dhe zia, këta të gjurë s'kanë pasurë fatin ta shohin në gjallëri Naimin: Po i kanë kënduarë librat shqip, i kanë mbajtur në zemrë vjershatë; ato vjersha u kanë dhënë dashuri për mëmëdhe e për njerëzi, ato libra u kanë rrë-

fyerë ç'është mirësija, dashurija, puna dhe jeta. Këta të gjerë janë të helmuarë që s'e panë dot sa ish gjallë, po kjo nuk' i ndalon të kenë nderim dhe dashuri të madhe për Shqiptar' e math që po shpohet në varr. Këta të tjerë s'janë shqipëtarë, po nga komb tjetër: turq, grekë, etj; kan' ardhurë me nder të math se kanë pasur fatnë të kuvendojnë me Naimnë dhejanë çuditur me diturinë, me mendjen, me sjelljen e bukurë të tij! Ja se ku po ecin me krye t'unjët gjithë këta njerëz; nga nderi arkën e mbahnë mi kokë më të lartë; ecin me ngadale, se trëmbenë të vënë në dhet këtë njeri të dashurë: duanë ta mahnë! Dhe sikur të munt t'i epësh shpirt përsëri, cilido do kursente të tinë? Ora 7. Arritme në varr. Këtu na pret një helm i ri: Jemi përpara varrit t'Abdul beut; kështu, pra, këta të dy vëllezërë që kanë rojtur bashkë, kanë punuarë bashkë, kanë pasurë një qël-


lim e një mendim, ë janë përpjekurë tërë jetën e tyre për Shqipërinë, janë dhe pas vdekjes ngjitur në varr! Shikoni, o njerës, ja se ku vihetë në varr Naimi! Naimi - babaj i shqipëtarëve, Naimi - babaj ynë, Naimi - mësonjësi ynë! Dy kut dhe arrijnë për këtë njeri të math e të dashurë! Ja, na humbi trupi, dheu po e mbulon, më s'e kemi për ta parë, më s'e kemi për ta dëgjuarë'. O njerës, gjithë kështu do vdesim'. Do vijë dita që të mbulohe mi në një gropë, që të na kalbenë e të na bëhenë hi dhe eshtërat! Ahere s'na ka për të mbeturë gjë nga këto poshtësitë e dheut! Alierë nga lakmin-i, nga ligësitë, nga poshtësitë, nga djallëzitë, nga marrëzitë, s'do të na mbesë fare gjësend; vetëm një kujtim do të mbesë te njerëzit: si lum ata që do të kujtohenë për të mirë, si mjerë ata që do të zihen ngoje për të ligë! Si mjer' ata që kanë qenë të liq, si lum

ata që kanë qenë të mirë! Perëndija do të na njohë gjithë punëtë. O njerës. Mirrni pjesë nga ky vend që po mbulohet para syvet: Naimi shkoj për jetë! Shkoj për ne, po vate te Perëndija. Neve na mësoj të bëhemi të mirë, të duhemi, të punojmë, të duam Shqipërinë. Mirrni pjesë nga ky njeri përpara varrit të të cilit po rrimë me sytë të lotuar! Mbani mënt fjalëtë që na thosh, këshillatë që na jepte'. Kijeni përshëmbllëse ish mirë, i virtutshëm, vetijë mirë, shpirt mirë, i ëmbël! Tek ai çdo njeri gjente një ndihmës, një këshillonjës, një baba. O shqipëtarë, në doni të nderoni kujtimin e këtij njeriu të math që po e qansot e tërë Shqipëria, mbani mënt fjalët e tij: Jeni të mirë, vetijë pastrë, doni mëmëdhenë dhe gjuhënë tuaj! U mbarua dhe shërbim'i fundit q'i bëmë këtij shqipëtar, të cilit i kemi detyrime të mëdha e të paharura sa të rrojë Shqipëria dhe gjuha shqipe.

Tani, gjithkush ng'ata që kish ardhurë të vërë në gji të dheut trupn' e Naimit, merr një udhë për të kthyerë, po me kokë t'unjur e i mejtuarë. Nga një breg kthejmë dhe një tjetër kokënë: ja se ku, atje tej, n'atë fshat më tej Ysqydarët, dy orë larg nga Stambolli, në Merdiven - Qoj, mbinjë breg, atje janë të dy varret: Njëri i ri, tjetri bërë më 11-të të Vjeshtës të dytë 1892; n'atavarrejanë mbuluar trupat e vdirshëm të dy vëllezërve; atje në atë fshat të vogël, larg nga Shqipëria, larg nga er' e Shqipërisë flenë përjetë dy njerës të shtrenjtë për ne; larg nga ajo Shqipëri për të cilën rojtnë! Po do të vijë dita - oh, - kemi shpresë të fortë - që do të lirohet dhe do të lulëzojë Shqipëria, dhe ahere, do të shpihen eshtrat e këtyre dy vëllezërve në Shqipëri dhe t'u gëzohet shpirti duke parë - qoftë pas vdekjes - prodhimin e farësë që mbuallë me aqë dëshirë. (1901)



Naim Frashëri



Mid'hat Frashëri

Betim Muço, një figurë e gjithanshme

SHKENCËTAR, SHKRIMTAR DHE PËRKTHYES

Dr. Muço ishte një mendje kureshtare me ndjeshmëri të lartë, me pasionin e studimit si domosdoshmëri jetike, me peshë mendimi dhe fuqi shprehëse, enciklopedik, me larmi të pasur tematike, me gjurmime e studime shkencore, artistike, gjuhësore, mitologjike, letrare...

Shefqet SALIU

Në sa e sa festivale të muzikës së lehtë në vitet '70-'80 kemi dëgjuar vargjet e këngëve të mrekullueshme

të Betim Muços, këtij poeti e shkrimtari të spikatur e talentuar, i cili, që me fillimet e botimeve në gjimnaz, arriti të botojë më shumë se 25 libra me poezi, tregime të shkurt-

ra, romane dhe ese, por edhe libra për fëmijë, duke përfshirë edhe tri koleksione përrallash, pa përmendur ato që nuk arriti t'i botonte. Ai fitoi disa çmime letrare në

Shqipëri dhe jashtë saj. Shumë nga poemat dhe tregimet e tij të shkurtra janë përkthyer dhe botuar në antologji letrare dhe revista në anglisht, rusisht, frëngjisht,

në gjuhën holandeze, rumune dhe turqisht. Ai ishte gjithashtu edhe një përkthyes i shkëlqyer në shqip i shumë autorëve të shquar botërorë në poezi e prozë. Libri i tij "Yjet janë fare pranë", i botuar pas vdekjes, u nderua me çmimin e "Librit dhe autorit më të mirë të vitit 2017" nga Panairi i Librit në Tiranë. Betimi u lind dhe shkëlqeu në Tiranë dhe, pavarësisht transferimeve të njëpasnjëshme të familjes se tij dhe persekutimit të padrejtë, ai u diplomua në degën e fizikës bërthamore në vitin 1970, dhe më pas u specializua në sizmologji. Ishte ndoshta i pari shqiptar që shkoi me studime pasuniversitare në Japoni (në një program 6-mujor në Universitetin e Tokios në 1990-1991), e që do të lidhej me atë vend të zhvilluar aziatik pazgjidhshmërisht duke u bërë edhe Konsull Nderi i Japonisë në Shqipëri për 10 vjet (1990-2000). Ai ishte dhe mbetet një shkencëtar i përmasave botërore. Letërsia dhe shkenca te Betimi ishin binom i pandarë. Talenti letrar duket sikur lindi bashkë me të, ndërsa karriera shkencore e tij përfshin më shumë se katër dekada. Betimi kontribuoi në praktikën e zhvillimit të sizmologjisë në Shqipëri dhe Ballkan përmes punës së tij në Institutin Sizmologjik (1974-2001). Ai u bë drejtor i këtij Instituti për disa vjet dhe më pas, si drejtor i Rrjetit Sizmologjik të Shqipërisë, drejtoi disa projekte ndërkombëtare dhe rajonale. Gjatë kësaj kohe botoi një gamë të gjerë artikujsh dhe librash shkencorë në Shqipëri dhe jashtë saj. Nga viti 1998 deri në 2005, Muço drejtoi dy projekte të Shkencës për Paqen të NATO-s mbi sizmologjinë në Shqipëri e Ballkan. Por, Shqipëria ishte e vogël për këtë shkencëtar të madh. Në vitin 2001, ai u transferua në Shtetet e Bashkuara së bashku me familjen dhe mori nënshtetësinë si një "individ me aftësi të jashtëzakonshme në shkencë dhe art" dhe "në interes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ku dhe vazhdoi punën e tij shkencore e letrare për 15 vjet, derisa sa ishte gjallë. Prof. dr. Betim Zihni Muço prezantoi punime shkencore në shumë konferenca në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, po vendlindjen nuke harroi, vinte shpesh me punësa ishte gjallë, ia donte puna dhe zemra. Ai zotëronte, veç gjuhës shqipe, anglishten dhe rusishten, po lexonte dhe përkthente edhe nga frëngjishtja, italishtja dhe serbo-kroatishtja. Punimet shkencore dhe vepra e tij letrare gjejnë një përdorim dhe lexim të adhurueshëm në ditët e sotme. Kam bindjen se edhe nga shumë breza në të ardhmen do të jete i adhuruar dhe pikë reference. Materialet e tij shkencore jepen leksione dhe studiohen në universitete, akademi dhe gjetkë. Prof. dr. Muço ishte një mendje kureshtarë me ndjeshmëri të lartë, me pasionin e studimit si domosdoshmëri jetike, me peshë mendimi dhe fuqi shprehëse, enciklopedik, me larmi të pasur tematike, me gjurmime e studime shkencore, artistike, gjuhësore, mitologjike, letrare, me shkrime fluturake dhe deri të studimeve në kërkim të një emocionishkencor. Po, ai është një libër jete që, përtej leximit të thjeshtë, kërkon të studiohet, shijohet, përtypet ngadalë, në heshtje e qetësi për vetë ngarkesën ideore që përmban dhe mesazhit që përcjell vepra e tij. Ai i takon plejadës së detit të përme-

tarëve të shquar të pendës naimiane dhe shkencëtarëve të mëdhenj të asaj treve, nga Sami Frashëri, Çako të Andokli Kostallari e Mentor Përmeti. Them kështu, dhe për faktin se i ati i tij, Zihniu, ishte nga Pagrija, nga një familje patriotike në breza dhe që ai vetë la bankat e gjimnazit të Shkodrës dhe doli në mal e luftoi heroikisht përballë okupatorëve deri në çlirimin e atdheut. Po edhe e ëma e Betimit vinte nga një derë e madhe, në një nga lagjet e Sevranit, e cila i dha atdheut dëshmorë në tre breza, në kohën e Rilindjes Kombëtare, në Luftën e Parë, por edhe në Luftën e Dytë botërore. Të tre trimave populli i trevës u këndon këngë. Sa ishte fëmijë, po edhe në rini, ai shkante shpesh në pushimet e verës në vendlindjen e prindërve. Ajo trevë e dyfekut dhe e dijes, patriotët po dhe njerëz të mençur e të thjeshtë të saj, fisnikë e punëtorë kanë lënë mbresa të thella. Shumë ngjarje të librave të tij kanë si tematikë atë treve, madje gjyshi i tij jo rrallë në librat e tij del personazh. Burim frymëzimi i krijimtarisë së tij janë edhe traditat e zakonit e trevës. Përmetarja Marta, bashkeshortja e Betimit, një intelektuale e shquar që bëri emër në Shqipëri dhe në Amerikë, thotë: "Betimi ishte para së gjithash një përmetar i mirë dhe ashtu mbeti derisa vdiq, ku shkante çdo verë në fëmijëri e në rininë e tij. Ai ishte mishërimi më i gjallë i vlerave të Përmetit, i dashur, i thjeshtë, me shpirt të butë dhe shumë tolerant, i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë". Betimi dhe Marta patën tre fëmijë: Vajza e madhe, Sagita, ka studiuar ne Harvard për Zhvillim Ndërkombëtar; vajza e dytë, Fedora, ka studiuar Shkenca Sociale dhe djali, Zinarti, ka studiuar Shkenca Kompjuterike. Poste honorifike e anëtarësi: Betim Muço ishte anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1998-2000); sekretar i përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të IUGG për Shqipërinë (1997-2002); përfaqësues i Shqipërisë në Shoqatën Ndërkombëtare të Sizmologjisë dhe Fizikës së Brendësisë së Tokës (IASPEI, 1997-2015); anëtar i Shoqatës Gjeofizike të Amerikës (AGU, 1994-2015); Përfaqësues kombëtar në Komisionin Sizmologjik Europian (1998-2015); anëtar i Shoqatës Gjeofizike Europiane (2000-2015); anëtar i Komitetit Themelues të Agjencisë Botërore të Monitorimit Planetar dhe Reduktimit të Riskut të Tërmeteve, Gjenevë, Zvicër (2001-2015); anëtar i jashtëm për Shqipërinë në Bordin e Drejtorëve të Instituteve Kërkimore të Bashkuara për Sizmologjinë (IRIS), SHBA (1994-2015); "Mjeshtër i Madh", Titull i akorduar pas vdekjes (2016) nga Presidenti i RSH. Veprimtaria shkencore dhe botuese: 4 libra mbi sizmologjinë, botuar në shqip (autor apo bashkautor) dhe një libër mbi rreziqet gjeologjike të Shqipërisë, botuar në anglisht (bashkautor); 39 artikuj shkencorë profesionalë botuar në revista të huaja apo ndërkombëtare të shkencave të tokës dhe në përmbledhje studimesh nga shtëpi botuese shkencore ndërkombëtare; 16 artikuj shkencorë botuar në revistat shkencore dhe përmbledhje veprimtarish në Shqipëri; 57 kumtesa, abstrakte, me gojë apo postera të paraqitur në veprimtari shkencore të huaja ndërkombëtare; 13 kumtesa paraqitur në veprimtari shkencore të vendit.

Punoi si: mësues i fizikës, matematikës e astronomisë në shkollën e mesme të përgjithshme "Shote Galica" Fushë-Krujë (1971-1974); kërkues kërkimor shkencor në Institutin e Sizmologjisë, Tiranë (1974-1993); Drejtor i Institutit të Sizmologjisë, Tiranë (1993-1997); Përgjegjës i Rrjetit Sizmologjik, Institutin e Sizmologjisë, Akademia e Shkencave, Tiranë (1997-2002). Në vitin 2001, zhvendoset me familjen në SHBA, në Maryland dhe në vitin 2007 merr qytetarinë amerikane; kryen detyrën e editorit shkencor në "General Dynamics Information Technology" (2003-2013); themelon dhe drejton Shtëpinë Botuese "Equinoxes Publishing House", LLC (2006-2015), ku boton 10 libra në shqip dhe një në anglisht; ndërsa në vitet 2002-2015 është konsulent në Incorporated Research Institutions for Seismology (IRIS), Washington DC, SHBA. Arsimi dhe kualifikimi: Në Qendrën Sizmologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë (1974-1982); Kandidat i Shkencave (1982); Shkencëtar vizitues (1990-1991); Institutin e Kërkimit të Tërmeteve, Universiteti i Tokios, Tokio, Japoni (6 muaj); Doktor i Shkencave, Teza:

"Veçori të tërmeteve të Shqipërisë dhe roli i ujërave nëntokësore në gjenerimin e tyre", Fakulteti i Gjeologjisë e Minierave (1992). Shkencëtar vizitues: Institutin e Gjeofizikës i Hamburgut, Hamburg, Gjermani (2 muaj, 1994). Titulli "Drejtues Kërkimesh" (ekuivalent me Profesor), titull i përjetshëm akorduar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Ministrisë Arsimit dhe Kulturës (1994). Shkencëtar vizitues: Departamenti i Shkencave të Tokës, Universiteti i Triestes, Trieste, Itali (nga 1 muaj, 1998 e '99); Shkencëtar vizitues: Institutin e Gjeofizikës, Universitetin e Karlsruhes, Karlsruhe, Gjermani (2 muaj, 2000). Betimi u shua nga jeta më 15 janar 2015. "Prof. dr. Betim Muço ishte shkencëtar (sizmolog dhe fizikant), unik në gjenezën shqiptare dhe i shumëvlerësuar nga çdo institut shkencor i globit. "Shqipëria nuk e di çfarë ka humbur..." është shprehur një nga kolegët e tij amerikanë. (illyria)

(Shënim: Nxjerrë nga libri 'Mërgata legjendare e Amerikës', Tiranë, vit i bot. 2021.)



Dritësi

INJORIMI I SHPIRTIT

Çfarë është ajo që ushqen shpirtin? Është çdo gjë që na prek thellë, që na bën të harrojmë kohën, që na ngop aq sa harrojmë të hamë dhe nuk kemi nevojë për ëmbëlsira, alkool, drogë apo ndonjë gjë tjetër, me të cilat përpiqemi të mpijmë vuajtjet tona të shkaktuara nga egoja që manipulon mendjen tonë

Nga Metin IZETI

Njerëzimi ka një lidhje dashurie me arsyen që filloi që në epokën e iluminizmit (shek. 18), kur u krijua një rebelim kundër çdo gjëje mbiracionale, besëtytnive dhe dogmave fetare dhe kështu shkoi në ekstremin tjetër. Elita shoqërore e kohës, e përbërë nga mendimtarë si Volteri, Jean-Jacques Rousseau, Immanuel Kant, Descartes dhe Isaac Newton, mbrojti prestigjin e arsyes mbi gjithçka tjetër, duke pretenduar se ne mund të racionalizojmë gjithçka në jetë dhe se arsyeja njerëzore mund të zgjidhë të gjitha problemet njerëzore. Ata njerëz, ata mendimtarë të mëdhenj të kohës së tyre, formësuan mënyrën se si njerëzimi e percepton ende botën sot. Si pasojë e asaj kohe, njerëzit anojnë nga arsyeja në kurriz të shpirtit dhe përpiqen të jetojnë të udhëhequr nga koka, sikur të ishte kurora e gjithçkaje. Ne jemi dashuruar marrëzisht me arsyen dhe kemi marginalizuar më së shumti gjithçka që ka të bëjë me

shpirtin dhe frymën (edukimi formal neglizhon ose e vendos zhvillimin e shpirtit në plan të dytë). Madje ne e racionalizojmë edhe përmasën e shpirtit, edhe pse nuk ka kuptim. Kështu mendimet tona morën forcë, u bënë shkaku i gjithçkaje dhe shpreja që duhet të na mundësojë të kemi mirëqenie. Vetëm, a është vërtet kështu? A janë intelektualët vërtet më të suksesshëm dhe më të lumtur se të tjerët? A është me të vërtetë arsyeja aq e vlefshme sa ne i japim meritat? A nuk e teprojmë pak?

Porta e hiçit

Qasja në gjithçka që nuk mund të kuptohet dhe shpjegohet, në të gjitha përvojat shpirtërore mistike, mrekullitë dhe përvojat e mrekullueshme, shtypet dhe marginalizohet si diçka e palogjikshme, dhe për këtë arsye e parëndësishme. Prandaj, gjatë jetës së tyre, shumë mistikë dhe shpirtërorë ishin institucionalisht të papranuar, të pashpërbly-

er dhe të padekoruar për shkak të kontekstit shoqëror që mbretëronte. Në ditën kur lindi dashuria për arsyen, ne vendosëm që Zoti është një qenie racionale dhe se çdo gjë që ndodh në jetën tonë duhet të ketë një arsye, jo thjesht një arsye, por një arsye logjike. Prandaj, çdo gjë që nuk mund të shpjegohet me arsye dhe që nuk ka logjikë sipas kuptimit të arsyes u konsiderua epavlerë, madje edhe e tallur. Në këtë mënyrë, shumë ide dhe opsione me vlerë të lartë, të paktueshme për logjikën instrumentale, lëvizin në vend ose keqpërdoren në trajta okultiste. Shkenca dhe filozofia moderne vazhdojnë të krijojnë probleme për njerëzit dhe kanë siklet në plotësimin e nevojave themelore shpirtërore, kuptimore dhe abstrakte të njerëzve. Na mbetet vetëm një mundësi: feja... Në këtë pikë, është e dobishme të sqarohet çka është kuptimi i vërtetë i fesë. Feja është përkufizimi i asaj që njerëzit kërkojnë të gjejnë kuptim në jetën e tyre, qoftë përmes interpreti-

meve të feve të shpallura ose përmes shkencës dhe filozofisë. Feja është një nevojë për njerëzit. Siguron transmetimin e kulturës dhe legjitimitetin e marrëdhënieve mes njerëzve. Prandaj, kur një njeri refuzon një fe, ai nuk mund të mos e kthejë në jetë diçka që zëvendëson fenë. Ash-tu si moderniteti i sotëm është kthyer në një fenomen që ngërthen të gjitha karakteristikat e fesë, por e kundërshton të njëjtën nëse është e pranishme në konceptet fetare. Feja jep lajme, dhe lajmet janë për të panjohurën dhe të padëshmuar. Ju pranoni ose refuzoni. Prandaj, feja është subjekt i besimit. Feja, e ndërtuar mbi besimin, përcakton natyrën e marrëdhënieve të njerëzve përmes urdhrave dhe ndalimeve. Njerëzit marrin parasysh perspektivën e fesë në marrëdhëniet e tyre me natyrën, si dhe në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin. Epistemikisht, feja është me origjinë lajmi. Domethënë, Zoti zgjedh një nga njerëzit,



e cakton atë si të dërguar dhe ia zbrit librin/shpalljen. Njerëzit e ndërtojnë botën e tyre të kuptimit sipas kësaj zbuluese. Kështu del në pah një element i ri epistemik. Islami bazohet në këtë element epistemik. Dija islame ka dy veçori themelore: haber/lajmi dhe ixhma/konsensusi. Haberi/lajmi është shpallje, është rregulluar që të përfshijë informacionin për shembullin e të dërguarit, që është shpjegimi i shpalljes. Ixhma/konsensusi është transferimi i përmbajtjes dhe zbatimi i lajmit për 'dëshminë e një komuniteti që nuk ka gjasa të gënjejë me marrëveshje'. Ne, edhe në qasjet filozofike ndaj qenies, gjithashtu duhet të marrim parasysh dallimin midis filozofisë moderne dhe filozofisë klasike dhe ndryshimin e dukshëm midis të dyjave, që të mund ta bëjmë të qartë vendin e filozofisë. Filozofia klasike, lëndë e saj e ndertonte në qasjet ndaj Zotit, njeriut, vdekjes, metafizikës dhe madje edhe jetës së përtejme përmes konceptimit dhe si rrjedhojë e bazonte pikëpamjen e saj mbi këto. Megjithatë, moderniteti e ka bërë arsyen bazën e njohjes së subjektit. Moderniteti u përpoq ta shpëtonte mendjen nga konceptimi dhe hermeneutika duke e kufizuar atë në

kufijtë e mendjes të shoqëruar me kategori dhe duke kufizuar njohuritë filozofike. Megjithatë, kjo gjendje e ngushtoi filozofinë duke i kthyer kufizimet e shkencës në kufizime të filozofisë. Kështu, bëri që mendja e njeriut të godiste në mur në fushën e jetës. Kjo qasje, e cila shquhet si kriza e Kantit, i hapi derën hiçit dhe pakuptimësisë për shkak të pazgjidshmërisë së saj. Dhe sot, filozofë si Habermas, të cilët mbrojnë modernitetin, bëjnë thirrje për nevojën për ta thirrur fenë në ndihmë. Me fjalë të tjera, filozofia moderne, e cila nuk i shërben qëllimit tjetër veçse burgosjes së njerëzve brenda kufijve të jetës, është e ekspozuar ndaj implikimeve 'të vdekura/të përfunduara'. Në çdo rast, inteligjenca artificiale dhe teknologjia robotike do të kërkojnë një epistemë krejtësisht të ndryshme. Është pothuajse koha që të shpallet fundi i njerëzimit nga aspekti i moskuzimit të zgjidhjes me instrumentet me të cilat funksionojmë.

Filozofët qëndrojnë kundër çdo lloj autoriteti

Nga këndvështrimi i filozofisë, feja nuk është armik. Është diçka që e intereson dhe e shqetëson atë." Pika

e parë që një filozof duhet të veprojë ndërsa filozofon është parimi, sipas fjalëve të Sokratit, "Nëse një gjë e di me siguri, është se nuk di asgjë". Detyra e filozofisë nuk është t'i japë fund diçkaje duke pretenduar se e di me siguri dhe të tronditë aftësinë e dyshimit dhe kritikës, por "të jetë gjithmonë në rrugën e duhur" duke vënë në dyshim kuptimin e gjithçkaje me të cilën merret. Tensioni dhe armiqësia ndërmjet fesë dhe filozofisë, e cila e ka bërë të ndjeshme praninë e saj gjatë historisë së mendimit, ka arritur kulmin me filozofinë iluministe dhe filozofinë bashkëkohore. Ky tension gradualisht është intensifikuar me mosnjohjen e të dyja palëve, duke e konsideruar njëra-tjetrën joadekuate, madje duke e refuzuar njëra-tjetrën si të dëmshme. Mendimtarët materialistë, pozitivistë dhe ateistë që e reduktojnë fenë në shkaqe natyrore ose e refuzojnë atë në baza shkencore dhe filozofike, e kanë nxitur më tej këtë konflikt. Në fakt, çështja është një luftë se kush do të jetë autoriteti në fushën politike, sociale, ekonomike, juridike, morale, estetike dhe epistemologjike dhe kush duhet të formësojë individin dhe shoqërinë. Në këtë luftë, një

krah të veçantë formojnë mendimtarët që nuk janë materialistë, pozitivistë apo ateistë, madje edhe vetë janë fetarë, por që besojnë se arsyeja dhe shkenca duhet të jenë autoriteti absolut edhe në fushat e përmendura dhe në fushën e fesë. Këta mendimtarë gjithashtu nuk pëlqehen nga autoritetet fetare dhe akuzohen se kanë krijuar fenë e tyre. Në sytë e këtyre mendimtarëve, feja e vërtetë është feja e bazuar në dituri dhe virtyt. Pothuajse të gjithë ata që kanë pasur nderintëecinsadopak në rrugë historisë së filozofisë, e dinë se filozofia ka qenë gjithmonë një aktivitet pyetës dhe analitik, dhe filozofi ka qenë gjithmonë një identitet që shkakton shqetësim duke pyetur. Ashtu siç tha Badiou, kudo ku ka një të ashtuquajtur të vërtetë /të pavërtetë që kërkon harmoni të përhershme, kënaqësi pa konflikt dhe përpjekje, pushtet pa kundërshtim, siguri dhe universalitet pa justifikim, ka filozofë që ndjekin të vërtetën, lirinë dhe autenticitetin. Për këtë arsye, qeveritë politike totalitare nuk kanë pasur marrëdhënie të mira me filozofët gjatë historisë. Sepse filozofët qëndrojnë kundër çdo lloj autoriteti/fuqie që kërkon/detyron të



merr përsipër identitetin tonë pa e vënë në pyetje dhe duke e asgjësuar atë. Filozofet e mirëfilltë besojnë se një e vërtetë që përqëndron mendjen e përbashkët të njerëzve dhe miratohet nga mendja kritike, dhe një autonomi dhe liri në drejtim të shfaqjes së guximit dhe vendosmërisë për të nxjerrë fatin e vet është mënyra e vetme që mund të sjellë lumturinë lëndore dhe mendore tek njerëzit. Filozofët janë avokatë madhështorë dhe flijues në rrugën e të vërtetës. Ata janë zemërgjerë, sepse kanë virtutin të mund të kritikojnë dhe të vënë në dyshim edhe veten pa mëshirë dhe me të njëjtën ndjeshmëri siç kritikojnë edhe tjerët. Duhet parë si një virtut i postmodernizmit që mendja zbret nga froni mbretëror dhe shkon në një pikë ku pranon gabueshmërinë e saj dhe kritikon veten si të pamjaftueshme dhe prej andej shkon drejt kanalit të arsyes së përbashkët. Mendja e modernizmit, duke vepruar me motivimin e shkencës/racionalitetit, zhvilloi strategji të ndryshme kundër fesë. Ajo ose krijoi një lloj feje të arsyes duke e futur fenë në një gjuhë dhe kallëp shkencor/racional - ashtu si Spinoza dhe Kanti, ose privilegjoji deizmin, ose shkëputi lidhjen me burimin transcendent të fesë dhe e ktheu atë në një mall që kënaq kërkimin e njerëzve për lumturi dhe paqe, ndersa fenë e shndërroi në vegël dhe refuzoi atë për arsye humanizmi, shkence apo lirie. Përballë këtyre strategjive, besimtarët nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të modernizonin fenë, pra të riinterpretinin fenë sipas kërkesave individuale dhe shoqërore të modernizimit dhe ta përshtatnin atë me kushtet e epokës, osetërefuzonin rëndësisht mendjen e modernizmit, duke akuzuar për blasfemi, perversion dhe në rastin më të mirë, pamundësi për të kuptuar fenë.

Refuzimi i arsyes nuk sjell shpëtim

Feja e përcakton jetën e njeriut si një vlerë gjithëpërfshirëse. Ajo mund të shndërrohet në një sistem që përfshin shkencën dhe filozofinë. Ka shembuj të tillë në histori. Feja është një vlerë ombrellë, filozofia dhe shkencat duhet të ngërthejë edhe vlerat fetare në një nivel që i bën ato më të kuptueshme. I shndërrohet ato në një nivel që mund të jene burim i aktiviteteve arsimore dhe kulturore. Shkenca mund të

trajtohet si vlerë në reciprocitet me fenë në një nivel që do të lehtësojë natyrën dhe jetën njerëzore. Mënyra për ta arritur këtë është gjetja e një mënyre për ta kthyer fenë, shkencën dhe filozofinë në identitetin e tyre origjinal. Vlefshmëria e këtij interpretimi brenda lëvizjeve të mendimit duhet të vihet në agjendën e kohës. Duke lënë mënjatë tiparet shterpe që ka marrë secila prej tyre në fushën e instrumentalizimit dhe nënshtrimi i tyre ndaj një vlerësimi të ri se cilit dimension të qenies njerëzore i përgjigjen do të lehtësojë zgjidhjen e problemit. Ajo që sjell ndarjen në agjendë mund të hapë rrugën për unitetin. Atëherë, shkenca, filozofia dhe feja nuk mund të pozicionohen në mënyrë të njëjtë, sepse ato funksionojnë në nivele të veçanta, por ata bashkërisht mund të ofrojnë bazën për harmoninë dhe jo konfliktin. Dhe çfarë është ajo që ushqen shpirtin? Është çdo gjë që na prek thellë, që na bën të harrojmë kohën, që na ngopaq sa harrojmë të hamë dhe nuk kemi nevojë për ëmbëlsira, alkool, drogë apo ndonjë gjë tjetër, me të cilat përpikemi të mpijmë vuajtjet tona të shkaktuara nga egoja që manipulon mendjen tonë. Si p.sh.: adhurimet fetare, kontemplimi, meditimi, disa vepra arti frymëzuese, aktivitete krijuese, qëndrimi në xhami, një shëtitje relaksuese në mal, shkuarja në natyrë, teatër apo ndonjë vend tjetër, dëgjimi i muzikës shpirtërore ose i zogjve, shikimi i peizazheve të bukura ose filma të veçantë artistikë, biseda me dikë që është në të njëjtën gjatësi vale, noti, qeshja, shikimi në sytë e foshnjës, leximi i poezisë. Çdo gjë që ushqen egon tuaj e privon shpirtin tuaj nga ushqimi. Prandaj, përmbahuni nga ushqyerja e egos tuaj në kurriz të shpirtit tuaj, pasi do ta pengoni shpirtin tuaj që t'ju udhëheqë drejt prosperitetit. Egoja nuk do t'ju çojë kurrë drejt mirëqenies, të paktën jo afatgjatë ose të përhershme. Egoja ju detyron të përdorni arsien si zotërinë tuaj dhe shpirti ju shtyn të përdorni arsien vetëm si shërbëtorin tuaj. Pra, çfarë është ajo që mund të na ofrojë shpëtimin? Cila është alternativa jonë? Sigurisht që nuk është të refuzosh arsien, as të jesh i paarsyeshëm - kjo sigurisht nuk është zgjidhja. Arsyeja duhet të jetë shërbëtori ynë, jo zotëria ynë. Mendja, trupi dhe ndjenjat janë shërbëtorë në shërbim të të vetmit zotëri të vërtetë - shpirt

njerëzor (i cili është një frymë e Fuqisë së Lartë). Prandaj, është më mirë se arsyeja të udhëhiqesh nga zëri i shpirtit tënd, i cili komunikon me ne përmes intuitës, ndërgjegjes, shqisës së gjashtë, imagjinatës, frymëzimit, vizioneve, ëndrrave, instinkteve (kur vetëdija jonë është në shkallën e duhur), larg nga e ashtuquajtura "rastësi" dhe të ngjashme. Çdo sëmundje dhe çdo krizë, qoftë financiare, dashurie apo shëndetësore, është një krizë shpirtërore dhe jo mendore. Prandaj në esencë pothuajse të gjitha sëmundjet janë shpirtërore. Është shpirti ai që vuan për shkak të neglizhencës së tij, ndërsa fizikisht na ndodh neve si tërësi. Për sa kohë që ne ushqejmë mendjen dhe jo shpirtin, do të na ndodhin të njëjtat modele që do të sjellin kriza në derën tonë. Për sa kohë që bëjmë një punë që nuk na pëlqen dhe përjetojmë konflikte me të tjerët, pavarësisht shpjegimeve logjike dhe justifikimeve të arsyeshme, do të kemi probleme shpirtërore sepse nuk është në përputhje me natyrën tonë, me shpirtin tonë. Për sa kohë që ne ndjekim vetëm idetë (të folurit e mendjes) pa intuitën apo ndërgjegjen tonë (të folurit e shpirtit), ne do të shkojmë në drejtimin e gabuar, në të kundërtën e mirëqenies. I gjithë ky model anakronik i përdorimit të arsyes nuk është funksional, megjithëse ka përfitimet e veta. Po të ishte, nuk do të na ndodhte ajo që na ndodh vazhdimisht dhe as intelektualët tanë nuk do të ishin aq të pakënaqur sa janë. Shikoni përreth jush dhe shikoni se cilët janë njerëzit që janë vërtet të lumtur dhe vërtet të shëndetshëm dhe të mbushur me dashuri dhe që jetojnë në prosperitet. A janë ata akademikë, pedagogë dhe të tjerë që udhëhiqen vetëm nga arsyeja? Apo janë disa njerëz të tjerë më pak të arsimuar, më pak të arsyeshëm? Edhe nëse intelektualët kanë status dhe reputacion të mirë në shoqëri, nuk do të thotë se janë të lumtur dhe të kënaqur. Pse arsyeja nuk i çoi të gjithë njerëzit me arsim të lartë drejt mirëqenies dhe kënaqësisë në jetë? Pyete veten dhe mos kërkoni përgjigje me arsye sepse thjesht do të rrotullohesh në rreth.

Mendja si parashuta

Nëse arsyeja do të ishte vërtet një "dashnor" kaq i përsosur, a do të

vuanim ne në atë "marrëdhënie dashurie" apo do të ishim të lumtur? Kush nga ata që mbështeten kryesisht në arsyen dhe aftësitë e tyre intelektuale është me të vërtetë i lumtur sot? Shumica e intelektualëve janë të prirur për të debatuar, kritikuar, dënuar, stuhi mendimesh...Përveç kësaj, ata kanë probleme financiare, dashurie dhe shëndetësore. Megjithatë, arsyeshmëria dhe intelektualiteti janë, pa dyshim, shumë më pozitive sesa sjellja dhe marrëzia e paarsyeshme. Askush nuk dyshon se arsyeja është e vlefshme, por pyetja është se në çfarë mase, apo nëse ka diçka më të mirë se arsyeja. Shumë intelektualë nuk do ta pranonin me vete se bëjnë një jetë të padenjë për një person me arsim të lartë dhe se dija dhe arsimimi, si dhe arsyeja, nuk i plotësuan pritshmëritë e tyre. Mendjet e tyre nuk janë të hapura për përgjigje të paarsyeshme. Mendja, ashtu si një parashutë, është e dobishme vetëm kur është e hapur. Si i racionalizon vetes një intelektual kaq shumë dekada të shpenzuara në mësimin dhe zhvillimin e aftësive intelektuale, për të përfunduar një jetë me të cilën nuk është i kënaqur? Si i racionalizon vetes një intelektual kaq shumë përpjekje të investuara për të ndërtuar diçka, qoftë kjo njohuri, aftësi, martesë, miqësi, biznes apo diçka tjetër, dhe që e gjithë kjo përfundon me probleme të përditshme, vuajtje, zhgënjime, konflikte, shëndet të dëmtuar, etj? Natyrisht, sipas vendeve dhe kohërave të ndryshme, ekzistojnë edhe metodologji të ndryshme për kryerjen e detyrës së përmendur. Mirëpo, metodologjia që nuk ndryshon dhe është e njëjtë në çdo kohë dhe në çdo vend është marrja në konsideratë e të gjitha përmasave njerëzore dhe mos marginalizimi i asnjërit prej tyre. Prandaj, besimi i pastër në vetvete përfaqëson thirrje për të Vërtetën. E vërteta në një farë mënyre duhet të përjetësohet dhe mbrohet nga përpjekjet për ta ndryshuar atë nën ndikimin e kuptimeve dhe perceptimeve të ndryshme. Njeriu asnjëherë nuk është dhe nuk do të jetë i pafuqishëm në jetën e njerëzishme dhe thirrjen në të Vërtetën, shmangien e së keqes dhe largimin prej saj dhe në këtë rrugë arsyeja dhe shkenca duhet t'i shërbejnë të Vërtetës dhe Qenies.

Ekspozitë e fotografit Fahredin SPAHIJA

PËRDITA IME E MUNGUEME

Çasti, tonet nga e bardha në të zezë apo anasjelltas, janë elemente që e karakterizojnë stilin e artistit. Vetëm përmes tyre, ai me një foto, e krijon skenën

Vlora ADEMI


Ekspozitën fotografike PËRDITA IME E MUNGUEME e karakterizon drama e një epoke. Drama e luftës, e ekzistencës, e boshit, e mungesës, e humbjes dhe shpërfytyrimit.

Dramën që e mbartin në vete portretet e realizueme të kësaj ekspozite, me shumë takt e dell, na i shpërfaq, artisti i fotografisë, Fahredin Spahija. Në fototekën e tij, ndër ma të pasunat e llojit të vet, karshi portreteve të figurave të njohuna nga fus-

ha e kulturës dhe, karshi nudove, me çka edhe i ka sfidue tabutë e shoqisë shqiptare të shekullit 21, zanë vend edhe dëshmitë e një epoke tragjike këtej e andej kufinit. Çasti, tonet nga e bardha në të zezë apo anasjelltas, janë elemente që e karak-


terizojnë stiline artistit. Vetëm përmes tyre, ai me një foto, e krijon skenën. Shpërfaqja e emocionit përmes tyre deri n'përlojtje, asht dhunti veç e një artisti me substancë e strukturë të pasun intelektuale. Për portretet mund të thuhet:

edhe pse kanë një vulë të dallueshme ka rrëmbye harresës vetëm një çast bës përtej një veteje të pabindun. hajt u realizua në kuadër të etnografie, ato priren ma shumë para se t'is i harrimit me ra mbi to. **(Prishtinë, shkurt, 2024)** Festivalit Ndërkombëtar të kah ekzotikja se janë elemente pik- PËRDITA IME E MUNGUEME P.S Poezisë REPUBLIKA, edicioni VI torike në zhdukje e që fotografi ia asht dedikim i përtypjes së dhim- Ekspozita e Fahredin Spa-




















GËRSHETIMI I TRAGJIKO- MIKES AKTUALE NË ROM- ANIN PËR FËMIJË

(Rreth romanit "O Lol" të Fran Ukcames)

Lumnie Thaçi-HALILI


Qënëtitull, kur pagëzohet një libër me emërtim të veçantë, menjëherë zgjohet kureshtja nga dëgjimi a shikimi emërtues për secilën vepër letrare, sidomos për romanin si zhanër. Lidhur me këtë shkrim, do të përveçojmë këtu romanin për fëmijë e të rinj të Fran Ukcames, me titull "O Lol". Pa filluar leximi më intrigoj ky titull, ndërkohë fillova të pyesja veten, se ç'nënkuptojnë këto katër shkronja O Lol: e para m'u dëftua si mënyrë thirrmore e emrit të përveçëm (sa më kujtoi rasën e pestë thirrmore të dikurshme (sot të shkrirë) të shqipes së mëhershme, ku emri lakohej edhe në këtë rasë, shpjegohet kështu: *sepse emënit që lakohet i bajmë një të thirrun*, në këtë rast do të ngjasonte si në titull O Lol; kurse tjetra m'u deshifrua si një shkurtesë përkëdhelie e ndonjë emri fëmije... Sidoqoftë, si njëra, po ashtu dhe tjetra ndërlidhen kontekstualisht edhe me brendinë. Romani në fjalë, është botuar nga Shtëpia Botuese "URA", në vitin e lënë pas (2023). Një roman, i cili jo vetëm që ia vlen të lexohet, por që duhet me patjetër të lexohet për shumë arsye. Fillimisht për tematikën interesante e të veçantë që mbarështron, i shkruar në mënyrën më mjeshtërore prozaikë, si një roman modern e bashkëkohor. Vetë objekti i romanit është konceptuar në një kohë të qëlluar dhe në një mënyrë të saktë rreth një dukurie a fenomeni të quajtur bulizëm, që në Fjalorin e shqipes si sinonime të përafërta do t'u përgjigjeshin këto fjalë: përbuzje, përçmim, përqeshje, përbaltje, përgojim, përleshje, përlyerje, përthyerje, përhedhje etj., ngjarja e të cilit ndodh brenda intervalit kohor, ku ndërthuret realiteti i vonshëm i një dergje (sëmundje), pandemia mbarënjerezore e planetit e quajtur me emrin Covid. Vetëm duke lexuar përgjithësisht njëqind e tri (103) faqet e romanit, do të shohë lexuesi mënyrën e ligjërim-it në mbarë romanin, e cila është specifike, lirisht mund të thuhet se është më e veçantë nga romanet tjera të letërsisë për fëmijë. Në nëntitullin e romanit, autori vendos dy vargje urtësie të rimuara sa në formën urdhërore po aq edhe lutëse: *Mos përbuz, o i bekuar, Përbuzja ves i shëmtuar (f.3)*. Struktura skeletore e romanit është ndërtuar përmes njëzet e katër (24) krerëve (kapitujve), duke i emëruar: kreu 1, kreu 2 e kështu radhazi, ku secili krye a kapitull emërtohet me nga një titull të veçantë, kështu që secili mund të qën-

drojë edhe si një tregim më vete. Subjekti i këtij romani është tërësisht real me ndërthurjen e fiksion-it që e mban pezull kërshërinë e lexuesit, tashmë të bindur edhe nga vepra tjera parake, të nxjerra nga brumi krijues e i pasur artistikisht, gjithashtu mjaft prodhimtar i vepërimitarisë letrare të Fran Ukcames. Duke e parë nga përmbajtja, mund të thuhet që është roman tragjikomik, përmbajtësish qëndron në drejtpeshoren e të dyja elementeve. Elementi tragjik pasqyrohet vetëm përmes personazhit a figurës kyçe në roman-Lolit, këtu karakterizohet, përqeshet e përbuzet (bulizohet) trupi i tij, i deformuar nga obeziteti, në tejmasë shëndetësore, të tepruar, si një objekt tallës nga të tjerët: rrethi e shoqëria. Gati në dhimbje të emocionojnë ngjarjet prekëse që ofendojnë dhe e emërtojnë me lloj-lloj nofkash e shprehjesh Lolin, sikurse: Loli kampioni; rinoqeronti; hipopotami; elefanti (f.7); kacek; viç; shejtani;

apo shprehja: u ngjit si viç bizoni; malukati Lol, ngjan si gorillë; o Loli o bidoni; bulldencë nipi (33). Kështu, duke ndjellë njëkohësisht tek lexuesi mëshirë e keqardhje për të-Lolin, ndërsa neveri e vrer për ofenduesit. Ani pse që nga antikiteti e deri në kohët e sotme koncepti dhe shkalla e tragjedisë ka ndryshuar, duke pësuar modifikime... sipas J.A.Guddon, prapëseprapë duke e lexuar këtë libër, lexuesi do të ndjejë dhimbje teksa sheh se si shkatërrohet prej bulizmit një fëmijë, i një familje të rëndomtë shqiptare. Fenomen mjaft i përhapur jo vetëm në shoqërinë shqiptare që jeton brenda këtij gadishullit të shkajshëm në Ballkan, por thuhet, edhe fenomen i gjithkundshëm në botë, madje edhe tek shoqëritë më të zhvilluara në përmasa dozash të ndryshme. Ndërsa, nga ana tjetër libri përmban edhe elementin komik. Prandaj, në parime të përbashkëta filozofike, përnjëmend mund të quhet bindshëm: roman tragjiko-

mik, tekqë harmonizohen natyrshëm situatat tragjike me ato komike, zhvillohen ngjarje qesharake e njëkohësisht edhe mallëngjyese. I tërë romani përbëhet prej një materiali të pasur leksikor, ku jepen mjaft informacione rreth pandemisë në përgjithësi, e veçanërisht rreth përjetimit e trajtimit të saj në Shqipëri. Përciptazi jepet mesazhi artistik i autorit për lexuesit, panjë theksim imponues a detyrues. Të gjitha ngjarjet në këtë libër ndërthuren natyrshëm me kontekstin e situatave të ndryshme për secilin mjedis: qytet, fshat, mal; familje, shtëpi, shkollë, rrugë etj. Mjeshtërisht autori i ka detajuar me përpikëri veprimet e personazheve në shumë situata. Bën strukturimin dhe konstituimin e shumë tabllave poetike në ligjërimin tekstual: *Lepurush, lepurush, pup e pup gëzof pambuk, Mustaqegjatë, veshllapush, lakra ha e brekët mbush...* (f.45)

Lirisht mund të thuhet, se jepen përshkrime të ndryshme të konkretizuara që nga fillimi e deri në fund të librit, duke i dhënë lexuesit shpjegime të duhura, gjë që e bën të çmuar si prozë me cilësi të mirëfilltë artistike. Përgjatë leximit, të thuash të njëfrymshëm, asgjë nuk të bëhet monotone, sepse gjithçmos bën autori për të mospërsëritur asgjë të panevojshme. Paraprakisht cilësohet për stilin e dendur e të ngritur gjuhësor, që në esencë, përmes figurave të ndryshme stilistike, pasqyron kështu me hove të veçanta rrjedhshmërinë e kulluar të mendimit a gjykimin për problemin e parashtuar rreth bulizmit, përbuzjes, përçmimit, injorimit, përqeshjes, me një ngjyrim estetik. Thënë shkurt, çdo ndërtim këtu në këtë roman, ka një funksion shprehës a stilistik, gjithmonë me një qëllim a funksion të caktuar për ta demaskuar bulizmin nëpër shkolla, si dukuri negative mjaft e përhapur sot, sidomos tek fëmijët, si grupmosha më e ndjeshme e kritike që mund të lërë pasojë të pandreqshme në rritjen e tyre drejt jetës në të ardhmen. Përshkrimi i karaktereve me tipare të caktuara në roman bëhet përmes figurave të shumta, aty gumëzhin një galeri të tërë: Loli-kryepersonazhi, gjyshi, gjyshja, Viktori i ati i Lolit, Tori, Caku, Marku, Gazi, Dea, Flutura, Arieta, Fatmira etj. Njerëz jo vetëm, por edhe kafshë: kaziu e buzi-gomerë. Vendin qendror në roman e zë figura e Lolit, ku vetëm një herë në libër thuhet emri e mbiemri i vërtetë i tij Aleksandër Kodra (f. 31). Në të gjitha ngjarjet ai është thjesht vetëm Lol, për gjithë të tjerët, përjashtim nga gjyshja që e thërret herë



Aleksandëre më shpesh Sandër. Itërë strumbullari i këtij romani shtjellohet rreth këtij karakteri, një djali adoloshent që nga përbuzja që i bëjnë, shfaqet i mërzhitur, është plot maraz, shpesh qan, ik nga orët mësimore, pavarësisht apelit inkurajues të mësuesve që jo rrallë ndërhyjnë me shprehje unifikuese, të tilla, si: është apelit inkurajues të mësuesve që jo rrallë ndërhyjnë me shprehje unifikuese, të tilla, si: *"Ju duhet t'i rrini afër... Loli nuk ka vëlla, po ju ka ju, a jemi ne si një familje, motra e vëllezër (f.9). Ju jeni si vëllezër e motar, përbuzja është vesi më i shëmtuar në një shoqëri të lirë (f.28)!* Janë shëmbëlltyrat ipikesiduhettjetjenëmësuesit. Si pasojë e përbuzjes (bulizmit), merr një vendim të prerë, lë shkollën, me një shënim në dërrasë: *Lamtumirë, më nuk do të më shikoni në këtë shkollë (f.27)!* Trishtimi arrin kulmin si shkak i përbuzjes, andaj s'kishte rrugë tjetër përpos arratisjes nga përçmimi a bulizmi, urretja, ngërdheshja e përhershme që i bëhej. Kështu u gjendëdyzuar, mesarratisjes apo fatalitetit-t'i jepte fund jetës. Fatmirësisht zgjodhi arratisjen. Pikërisht prej këtu fillon lufta këmbëngulëse e Lolit për t'u përballur

me përbuzjen (bulizmin), kur i vë Jo-në e fortë përfundimit tragjik: *"Jo, kurrë nuk do ta bëj, do të gjej zgjidhje. Ata do t'i sfidoj. O do t'i çmend, o s'ka. Kur të më shikojnë s'kanë për të më njohur (f.29)."* Kështu, i shoqëruar nga gjyshiniset i maskuar me pezëm në zemër duke belbëzuar: *"Ah të mallkuarit ma nxinë jetën (f.32)."* Raporti mes gjyshit e nipit-Lolit, duket shumë i sinqertë, nis që kur filon udhëtimi për në fshat. Ai-gjyshi, për Lolin është heroi, motivuesi, përkrahësi, ideatori i transformimit të tij, aktori, ushtari, luftëtari, mbrojtësi. Që në fillim i jep zemër: *"Ti je me mua, një ushtri të vijë e zmbrops. Rri këtu... (f.37)."* Përgjatë qëndrimit në mal, ai njëzëshëm pëshpëriste: *"Eh i miri i gjyshit, llupësi i gjyshit, do ta ul unë atë kamerdare autokombajne, shpejt ke për të parë... (f.40)."* Rrjedhimisht edhe kështu ndodhi, me vrapime, gjimnastikë, punë fizike, ushqime të shëndetshme, pa konservime. Brenda natyrës malore merrnin ajrin e pastër, ujin e krojeve, diellin e ushqimin, Loli nis ndryshimin që nga mënyra e stilit të jetesës, andaj për të ky qëndrim do

të përkthehet si fat në këto rrethana fatkeqësie. Përveç këtyre, natyra e bëri edhe më trim, i dha lirinë, duke i krijuar vetëbesim. Duke qëndruar më gjatë seç menduan, rrethanat e tilla i përfruan edhe më shumë këta dy breza: nip e gjysh. Gjyshi bartte ndodhitë e kohës së shkuar nga rinia e tij tek nipi, në formë rrëfenjash, në këtë ishte i pakundshoq. Filloi me historitë e luftës. Dialogët e tyre s'kanë të sosur: *se do të më tregosh një rrëfenjë,* - foli Loli.

-Po dale, dale se nuk po na ndjek jermani.

-Kush është jermani?

-Po gjermani o derëbardhë (f.42).

Leksemat e qëllimshme deformuese nga fjalorthi i gjyshit, si: jerman për gjerman, thatro për teatër, internet për internet, Hodivull për Hollivud, i japin dozë shpotitëse humorit në ligjërimin tekstual. Ajo që e bën të veçantë këtë roman janë dialogët e shumtë, të cilët janë më se të gjalla e të afërta me përmbajtje trajtash e shprehjesh të theksuara dialektore të zonës, duke e përfruar kështu e bërë njësh karakterin e personazhit me vendin a mjedisin ku veprojnë. Po më

të përkryera shfaqen bashkëbisedat në largësi- distancë, përmes thirrmashe të ndryshme të gjyshit Demë e gjyshes Dedushe, në kreun e 11-të. Nga sa u pa, ngjarjet përbuzëse në roman fillojnë në Fier, zbarkojnë më vonë rrugës malore, vendosen në fshat me transformimin e Lolit, ku i pret edhe gjyshja, dhe rikthehen përfundimisht triumfuese në Fier. Ai, tashmë është atlet, i transformuar fizikisht për mirë, fiton medaljen e Maratonës së qytetit. Mirëpo, përveç trofeut, ai rifitoi edhe shoqërinë e humbur. Sa me vlerë është thënia, se *"Për të ndryshuar të tjerët, duhet së pari të ndryshojmë vetveten."* Çdo ndryshim në familje, shoqëri e komb nis nga vetvetja. Të gjitha këto që u sipërthanë, e bëjnë romanin "o Lol" të F. Ukcarnës të realizuar artistikisht bukur, jo vetëm si libër prozaik që të falë kënaqësinë e leximit me informim, argëtim, guxim e tjetërsim, duke ndryshuar formë e ide konceptuale, por edhe mund të bëhet skenar filmi i suksesshëm i fushës virtuale kinematografike. E deri te ky realizim, i cili do ta mrekullonte çdo artdashës, mbe temi me lutjen e shumë dëshiruar për vetëdijësim drejt avancimit: U bëftë!

Recension

GJENEZA

(Neviana Shehi, "Edhe perënditë pushojnë të shtunën", poezi, botoi Armagedoni, Prishtinë, 2023)

Avni HALIMI

Bota mitologjike ka qenë, është dhe do të ngelë terren me elementë të pashtershëm për krijimtarinë artistike. Nëse flasim për shtrirjen substitutive të mitit në vepër, në fakt do të bëhet fjalë për përshkrimin e ngjarjeve mitike, për përfshirjen e personazheve dhe karaktereve mitike gati të ngjashëm në shumë vepra të ndryshme dhe, dallimin e bën vetëm stili, gjuha, narracionidhemjeshteria e krijuesit për ta transponuar në vepër me vlera universale (demitizimi i kohës dhe hapësirës që gjendet nëpër motivet biblike-mitologjike). Kësisoj na sillen vepra me përmbajtje krejtësisht të reja dhe autonome. Në periudhën e Renesancës në pikturë e skulpturë, ndërsa kah shekulli XIX dhe në fillim të shekullit XX në letërsi, kemi përpjekje të theksuara për një rimitologjizim të krijimtarisë, respektivisht për lindjen e fenomenit estetik që kritika e krijimtarisë artistike do ta nënvizojë si mitopoetikë! Elementet mitologjike, krahas të legjendave dhe eposit nacional, i gjejmë ngjeshur gjithandej edhe në krijimtarinë artistike shqiptare. Natyrisht, më shumë në roman, në dramë, në pikturë e skulpturë dhe, shumë më pak në poezi, sidomos në atë bashkëkohore. Kohë më parë, Shtëpia Botuese "ARMAGEDONI" e Prishtinës, botoi përmbledhjen me poezi "EDHE PERËNDITË PUSHOJNË TË SHTUNËN", të poetes tashmë të mirënjohur, Neviana Shehi. Qysh në titull vërehet intenca e shpirtit krijues për ta demitizuar kohën-njëditë, e cila duhet t'i falet dashurisë: *"koha e dashurisë/ patjetër duhet*

të jetë e shtuna/ sepse të shtunën / edhe perënditë bëjnë pushim!" Bota mito-poetike në përmbledhjen e Shehit është relativisht prezent. Autorja tashmë e dëshmuar si mjeshtrë e ndërtimit estetik përmes tropeve të ndryshme që i vë në funksion të shtimit të fuqisë shprehëse të ligjërimin poetik, nuk vjel nga mitet ngjarje për t'ia sjellë recipientit në format poetik që e kërkon struktura e poezisë moderne. Poetja nuk flet për një ngjarje që ka ndodhur në kohën shumë të lashtë e që e përdor për ndonjë paralele apo krahasim! Autorja nuk mëton të sjellë te lexuesi informacione të rëndomta mbi personazhet mitike që kanë vepruar në një kohë e hapësirë imagjinare. Neviana Shehi, përmes poezisë së vet, na sjell mjaft ndodhi, ngjarje e personazhe, të cilët, tashmë, ose kanë marrë karakterin e figurave mitike, ose në një kohë tjetër, pas shumë mileniumeve, mund edhe të rrëfohen si mite të kohës së sotme. Si një mjeshtrë e rrallë e poezisë bashkëkohore shqipe, Shehi përmes vargut të vet, fuqishëm depërton në mite e legjenda dhe nga aty nuk del pa i kthjelluar burimet e shkaqeve që sjellin deri te ndodhitë e së sotmes. Këtë gjakim të krijueses e hasim që në njësinë hyrëse në përmbledhjen, *"Ne s'kishim këngë..."* Ndonëse dëshmohej me dhembje e pa patetikë, me sinqeritet e me bindje, autorja shpalos një histori të gjatë sa dhjetë stina të acarta, që e pohojnë një fakt të pamohueshëm, sa të saktë aq edhe epokal: *"Zoti na kishte dënuar/ të mos ishim endacakë"* Por, me rrënjë të përforcuar për trullall i pritej ajo këngë që na kishte munguar. Pritej liria, e cila, hi-

pur mbi kuajt e eposit, kishte marrë udhë dhe do të vinte! Për të ardhur liria duhet që një popull ta vuajë mallkimin e të mosqenët endacak, por të përforcuar për atdheun, kënga do të vinte e do ta flakte dhembjen, vajin, kujën, trishtimin. *"Ne s'kishim këngën/ por e ndienim, në zemër/ në shpirt/ e ndienim se do të vijë/ me kuajt e eposit!"* Pra, autorja këmbëngulëse se historia e jetës thotë: si nëpër gojëdhëna, ash-tu edhe ndër shekuj, liria është nisur me kuajt e luftës dhe, përtej mjegullnajave dhe dimrave të acartë, ajo do të vijë, siç vjen kënga që i jep kuptim jetës, ngjashëm si liria. Kjo është enigma e mitit, zgjidhja e së cilës na e jep definicionin e tij. Pra, miti është rrëfim i cili mëton të ofrojë shpjegime mbi shfaqjen e sërë besimeve dhe fenomeneve natyrore. Nëse nuk besohet se liria është nisur me kuajt e eposeve nëpër dhjetëra dimra të acartë, atëherë përjetë do të lëngoje shpirti i kryqëzuar i cili, nga dhembja e trishtë nuk e ndjenë këngën as edhe ekzistimin e saj. Kurse liria shfaqet bashkë me Zotin! Neviana Shehi, në këtë pikë, si në nyjet filmike që ndajnë ngjarjen prej ngjarjes, tërheq kufirin në mes të mitit dhe legjendës. Derisa legjendat ngrenë rrëfimet inekzistente mbi heronjtë dhe qeniet njerëzore, miti më tepër jepet pasqenieve dhe fenomeneve të hyjnishme. Liria erdhi me Zotin, por dhe kënga ka Perëndinë e vet. Që të dyja këto vlera të hyjnishme i dedikohen popullit të dënuar që të mos jetë endacak; për endacakët që ikin nga liria, është vetëm trishtimi, dhembja, vaji. Një prej krijimeve më mitopoetike në poezinë shqipe, e cila, veç të tjer-


ash dëshmon edhe për mjeshtrërinë e rrallëtë Neviana Shehit në zbërthimin e fenomeneve prej pikës fillestare, pra, hapësirës apo "vendit të shenjtë", e deri te "Dora e Zotit" që e rregullon kaosin, gjegjësisht kosmosin në pikën fillestare, është poezia antologjike "Gjeneza"! Gjithçka në këtë botë fillin e ka nga Toka dhe nga Gruaja, trupi i së cilës është vetëm një zgjatim i tokës dhe anasjelltas. Madje, edhe gjethet që e mbulonin këtë trup kishin po të njëjtën ngjyrë dhe klorofil si të pyllit, gjethet këto që ishin fotografi të para të shkrepara nga pranvera, nga kjo stinë që i jep fund kaosit e që zbulon fillin e gjenezës: *"Ky ishte dhe shkaku që ai peizazh/ i bukur dhe vallja mistike/ e vajzës së panjohur prej gjethesh/ i rikujtoi pyllit dhe tokës/ se kufiri mes tyre/ s'kishte ekzistuar asnjëherë/ se gjeneza është e njëjtë/ për të dyja!"* Po kaq e fuqishme është edhe poezia "Rikthimi në gjenezë", e cila përbehet nga pamjet që shfletohen në retrospektivë, nga pika e fundit drejt pikës së parë, por që, diku rrugës, shpërfaqen fenomene që e pamundësojnë arritjen te elementi i parë: *"Tash që faji/ është bërë shkëmb/ rikthimi i juaj në gjenezë/ është diçka e pamundur!"* Sprovën e autores për rikëndim, madje edhe për rikrijim të legjendës, e hasim në çdo cikël të kësaj përmbledhje dhe, pa mëdyshje, duhet pranuar se në krijimtarinë letrare tash e kemi edhe angazhimin për rindërtim të legjendës, të legjendave të njohura për lexuesin shqiptar, por që asnjëherë nuk është kapur për dore ky lexues e nuk është shpjerë në kohën dhe hapësirën kur ka ndodhur ajo. Krijuesi dhe lexuesi zbresin në

legjendë, marrin pjesë në ngjarje. Në momentin kur na dalin si vëzhgues të ngjarjeve, marrin pamjen e qenieve të rëndomtë, pa forcë për t'i besuar syve për atë që shohin dhe të pafuqishëm për t'ju besuar të gjitha informacioneve dhe, siç thotë autorja: "Përpara se ta besoj këtë/ më mirë po i mbyll veshët". Natyrisht, Neviana Shehi, në këtë përmbledhje nuk kapet vetëm për një lajtmotiv që vjen nga lashtësia mitike apo epike! Kapet edhe për problemet aktuale, porse, gjithsesi, edhe këtyre problemeve i jep peshë dhe përmasa epike e mitologjike. Poetesa është çame dhe, në të gjitha përmbledhjet e saj ajo i ka kënduar Çamërisë, vajzës

çame, popullit çam dhe, së fundmi edhe dallëndyshe çame që pret zotin e vet ulur në degën e ullirit pa zot në tokën e vet çame! Poezia "Vdekja e ullirit të lashtë dhe dallëndyshe çame" është një prej metaforave më të fuqishme në poezinë shqiptare kushtuar Çamërisë dhe etnitetit çam, metaforë që zberthen shmangien shqiptare nga kjo hallkë e identitetit kombëtar, vrasjen e kujtimit (dallëndyshe) dhe të qëndresës (ullirit) kombëtare, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, zhgënjim dhe protestë krijuese që personifikon revoltën kombëtare kundër çdo përpjeke për t'i dhënë problemit çam pamjen e një medaljoni që në të dy faqen

e saj paraqet pikëllim: "Një kokë e ngrirë dallëndyshe/ mbi një degë të tharë ulliri". Neviana Shehi me sukses provon edhe "afinitetin hyjnor" duke u dhënë shpirt figurave-personazheve të saj. Kësaj ia del duke u zhytur brenda figurave-personazheve, madje, përveç kësaj, ia del që edhe fenomenet natyrore t'i zberthejë në qenie të padukshme, të mbinatyrshe, me fuqi hyji, dhe të duken si personazhe me pamje mjegulle, me fuqinë e kujtimit, me forcën dëshpëruese të trishtimit. Nga njëra poezi në tjetrën shëtisin: "banori i heshtjes", "fisi i letres", "fytyra e vonesës", "kukullat kineze", "të çmendurit", ushtari prej

plasteline", "ushtarët e shiut", "burra porcelani", "butakshiu", "gruaja", "kalligula", "madam hëna", "njerëzit prej guri", pastaj: "libra ujqore", "vdekja e gjinkallave", "detet e natës", "zbritja e engjëjve të bekimit", "deti në dimër", "biblioteka e vogël e restorantit", "e shtuna e dashurisë" etj. Dhe, për tërë këtë botë fiktive, me plotë shpirt, erëra e ngjyra, autorja thotë: "Çdo çast nga gjuha e tyre/ del nga një curril i zjarrtë, që mund ta djeg ajrin/ dhe mua", apo: "Kufoma shkrimtarësh/ dhe poetësh të mëdhenj/ shtrirë mbi pluhur rënkojnë", apo: "Logjika e letres nuk është vetëm shfletimi/ por edhe biseda gojë më gojë me germa..."



Tregim

YLLI I GJENERALIT

Zija Çela

Zoti Nerali ishte njëngatrespecialistët civilë që dikur qenë thirrur të punonin për nevojat e ushtrisë. Si ia dolën ta modifikonin kimikisht eksplozivin sekret NTZ-6-E, me propozim të Ministrisë së Mbrojtjes underuan formalisht me gradën e kapitenit dhe pastaj iu rikthyen jetës së mëparshme. Nuk mund të thuhej se Gjin Nerali i kishte ecur mbarë në jetën civile. Pas divorcit me gruan e parë kishte bashkëjetuar disa vjet me të dytën, por pa e ndryshuar regjimin e tij. Lexime me orë të zgjatura, artikuj studimorë për revista shkencore, udhëtime këtej dhe matanë detit. Derisa, një ditë prej ditësh, Meri V. i la lamtumirën me arsyetimin: "Unë

nuk të kërkova të bësh çfarë nuk mundesh, por u pengova të bëja çfarë dua vetë." Dhe pa ruajtur më asnjë lidhje, me dëshirën për "mbrëmje romantike dhe ekstaze" (citim nga letra), shkoi për ta gëzuar jetën gjatë. Më në fund, në moshën 64-vjeçare, kur partnerja ishte 27, zotit Nerali i ndriti fati. Ai u bë me djalë. Foshnja ishte fryt i marrëdhënies së tij me kujdestaren e vilës, e cila kishte rënë në dashuri me kapitenin nga intervistat e tij televizive. Burrë me pamje kaq fisnike nuk kisha parë ndonjëherë në ekranet tona, do t'i thoshte Janica më vonë. Ajo ishte punësuar aty pas një jete disi të bujshme, në fillim si striptiste, në vijim si modele për një agjenci reklamash, më pas duke pozuar nudo për piktorë e

fotografë, ndoshta edhe duke fjetur herë-herë në studiot e tyre. I prekur në nderin e familjes, përveçse e dëboi nga shtëpia, për sjelljen skandaloze i vëllai e mohoi motrën, duke u pohuar kushërinjve: "Sa të kem frymë në këtë jetë, asaj putanës kurrën e kurrës nuk dua t'ia dëgjoj as emrin!" Por si ndodhi që Janica u bë nënë? Një pasdite, Gjin Nerali u ndie i drobitur dhe zuri shtratin. Në muzg, kur kujdestarja dhe gruaja e shërbimit mund të largoheshin nga vila, ato ranë në marrëveshje. Për herë të parë, për t'i qëndruar te koka zotërisë, kujdestarja do ta gdhinte natën në vilë. Pasi kishte telefonuar dy herë në Qendrën e Urgjencës dhe në të tretën i thanë sërish që, nëse pacienti kishte dhimbje fyti, të përdorte

spray propolis ose brufon, Janica e mbylli telefonin pa i dëgjuar këshillat e tjera. Pastaj iu kthye të sëmurit, që po dridhej nga ethet: - Ka dhe një mënyrë tjetër për ta ngrohur trupin tënd, major. - Si, si the?! - ia priti me habi tjetri. - Po unë nuk kam qenë kurrë as kapiten i vërtetë, Janica! Ndërkaq, i kthyer në krah dhe i alarmuar ngapamjet që shihten në pasqyrë, zoti Nerali u përpoq ta ndalonte, duke i kujtuar se simptomat e sëmundjes së tij mund të ishin Corona... - Mekuorë apakurorë, të dy bashkësi burrë e grua, - ia preu e vendosur kujdestarja e shtëpisë, e cilapomerre tepër sipër edhe kujdesin për shëndetin e tij. E zhveshur lakuriq, ajo hyri nën mbulesa. Thuajse përnjëherë ia kaloi

krahun nën sjetull, në mënyrë që t'ia përfshinte kraharorin dhe nisi të ngjishej pas kurrizit të tij për ta ngrohur. Pa u mbushur dy muaj, partnerët shkëmbyen lajme. Janica tha se ishte shtatzënë, ndërsa ai tha se do të kurorëzoheshin zyrtarisht si burrë e grua. Me t'u celebruar, çifti u nis për një udhëtim turistik. Mirëpo, kushedi përse, asnjëri nuk tha "muaj mjalti". Gjin Nerali kishte trashëguar aq pasuri nga gjyshi e stërgjyshi, sa vetëm me qiratë e pronave të patundshme mund të bënte jetë të luksi. Sado që ai nuk shquhej për dorëlëshuar, siç nuk ishte as cingun, në kthim valixhet e bashkëshortes ishin përplot me dhurata. Gjatë lindjes së fëmijës, atij nuk i bëri zemra të ishte i pranishëm në sallë. Por në shtëpinë e tyre, teksa po e kalonte foshnjën në krahët e të shoqit, gruaja i kujtoi gjithë ngazëllim: - Ja ku e ke tani djalin tënd, Gjin Nerali im! - Si, si the?! - pyeti buzagaz ai. Dhe Janica, duke kuptuar se vesh-

ët e tij e kishin dëgjuar ndryshe, i dha mbështetje pa ngurrim: - Gjenerali im, thashë. Ahere ai qeshi me zë. Por nuk e fshehu kënaqësinë. - Po, me trashëgimtarin që kemi, ti më bërë gjeneral, Janica ime. Por djalin do ta humbitnin, ndërsa trashëgimia do t'i kalonte së shpejtë. Mjekët qenë të bindur për diagnozën dhe, për shkak të asaj leucemie të egër, e parashikuan fundin e shpejtë. Egzoni tashmë sapo i kishte mbushur pesë vjeç. Pak kohë para se të sëmurej, ai kishte dëshmuar se i pëlqente deti, prandaj prindërit nuk i ndaluan shëtitjet me skaf. Njëherë, skafisti nxori nga uji një gjallesë ngjyrë okër dhe, i entuziazmuar nga aylli, fëmija deshi ta merrte me vete. Por i ati i tha se shtëpia e atij ylli ishte deti, ndërsa në shtëpinë e tyre do të vinte një yll tjetër. Dhe erdhi me të vërtetë. Pas tri ditësh, fëmija e pa në fundin e pishinës dhe thirri i mahnitur: "Uaa, sa i madh ky yll ynë!" Ishte po në atë ngjyrë si idetit, veçse diametri i kalon-

te edhe krahët e shtrirë të vogëlushit. Në krye të çdo jave, zoti Nerali bënte porosi të re dhe tapicierët e sajnin yllin me moket okër, duke i rritur përmasat. Meqë prindërit i thoshin se një djalë i vogël mund të rritet kështu çdo javë, për t'u bërë i madh një ditë, ai besonte se po rritej bashkë me yllin. Pormë të madhin, cepat e të cilizunë tërë gjerësinë e pishinës, fëmija nuk arriti ta shihte. Megjithatë prindërit e mbajtën në krahë, duke i ardhur rrotull disa herë buzës së ujit, Egzoni as e ngriti kokën e varur, as i hapi sytë. Rreth tre vjet më mbrapa ndërroi jetë edhe Gjin. Vdekja që e papritur (një sulm i gjakut në tru), por nuk e gjeti të papërgatitur. Në prillin e atij viti, ditën që e shoqja mbushi tridhjetë e pesë vjet, në prani të avokatit të tij kishte nënshkruar testamentin, sipas të cilit pasurinë ia linte trashëgim zonjës Janica Nerali. Vejusha nuk priti gjatë. Dështoi në përpjekjen e parë, pormbetishtëzënë në të dytën. Meqë lindi përtej afatit nga vdekja e të shoqit, u përfol se do-

biçin e kishte me dashnorin. Sepse: "Janica nuk është Maria, ajo s'mund të mbarset me frymën e shenjtë!" Doli se njeriu që shihej të hynte shpesh në vilë ishte vëllai i saj, pikërisht ai që ishte betuar për mohim të përjetshëm dhe që tashmë ishte kthyer te "putana" pasanike. Vetë Janica, ndonëse mund të sillte prova nga Banka e Spermës, nuk u mor me hamendjet që qarkullonin. Për ta mbrojtur barrën, bëri jetë sa më të shëndetshme. Veçse kësaj here lindi me cezarian. Derisa e solli fëmijën në jetë, pati kohë ta zgjidhte edhe mëdyshjen e saj. Nuk i vuri emrin e të shoqit, por e quajti Ylli. Madje, si kaluan ca vite dhe thashethemet po harroheshin, djali filloi të njihej edhe si Ylli i Gjeneralit. Ndoshta prej atij yllit me aliazhe speciale që, kur i binte dielli, shkëlqente nga larg përmbi pllakën e varrit të Gjin Neralit.

Tiranë, gusht 2020



Studim

LETËRSIA E PENGUAR

Letërsia e penguar i shpëtoi mitologjisë së socrealizmit me mitin e atdheut socialist, mitin e heroit socialist, me mitin e njeriut të ri, mitin e sigurimit të shtetit, mitin e partisë së lavdishme, me mitin e së ardhmes së lumtur, me mitin e fanarit ndriçues etj

Dr. Yzedin HIMA

Letërsia e penguar u shkrua në burgjet e diktaturës dhe në kampet e përqendrimit të të dënuarve dhe internuarve. Për disa raste mund të themi se u konceptua në mendjen e shkrimtarit dhe poetit në burgje dhe u hodh në letër më pas për arsye që merren me mend. Kjo letërsi

u shkrua normalisht nga shkrimtarë të talentuar, që nuk bënë asnjë kompromis në dëm të artit të tyre, por që e pësuan kur tekstet e tyre i çuan për botim në shtëpinë botuese. Një ndër shkrimtarët emblematikë të këtij grupi është Visar Zhiti, cili pas burgosjes, e vazhdoi krijimtarinë e tij në burgjet e diktaturës. Disa shkrimtarë dhe poetë ia dolën

të largoheshin nga vendi dhe e vazhduan krijimtarinë e tyre në Perëndim si Martin Camaj, Arshi Pipa, Bilal Xhaferi dhe Gjek Marinaj. Letërsia e penguar i shpëtoi mitologjisë së socrealizmit me mitin e atdheut socialist, mitin e heroit socialist, me mitin e njeriut të ri, mitin e sigurimit të shtetit, mitin e partisë së lavdishme, me mitin e së ardh-

mes së lumtur, me mitin e fanarit ndriçues etj. Mitologjia e Letërsisë së Rilindjes dhe Letërsisë së modernitetit u zëvendësuan nga mitologjia e e realizmit socialist dhe konkretisht: Mitin e gjuhës shqipe, aq të pranishëm në letërsinë pararendës si në shkrimtarinë e "Letërsisë së romantizmit", por edhe në atë të "Letërsisë së mo-

dernitetit” e zëvendëson me mitin e fjalimeve të udhëheqësit. Mitin e heroit romantik nacional e zëvendëson me mitin lejfenian të njeriut të ri. Mitin e armikut të kombit e zëvendëson me mitin e armikut të klasës. Mitin e dashurisë për atdheun e zëvendëson me mitin e dashurisë për partinë, ndërsa mitin e njeriut të vetmuar të letërsisë së modernitetit të viteve '30 e zëvendësoi me mitin e turmës revolucionare. Letërsia moderne e gjysmës së parë të shekullit XX njohu një relief me maja të tilla të krahasueshme me relievin e letërsisë bashkëkohore europiane me tekstet letrare të autorëve të shquar, si Konica, Fishta, Asdreni, Noli, Koliqi, Poradeci, Migjeni, Kute- li etj. Pikërisht trysnia e rrjedhës së kësaj letërsie, e shtratëzuar në periudhën e Rilindjes kombëtare dhe me profil të qartë si letërsi si e tillë gjatë periudhës së Letërsisë së modernitetit, vijoi në kushte tejet të rënda pas vendosjes së diktaturës komuniste në Shqipëri. Ajo vazhdoi rrjedhën si Letërsi e penguar. Vijmë në përfundimin se rrjedha e kësaj letërsie u shndërrua në rrjedhëz për shkak të kushteve që u krijuan, por duke ruajtur tiparet më të mira të rrjedhës. Tekstet letrare të autorëve të shquar të Letërsisë së penguar për nga cilësia artistike qëndrojnë krahas teksteve letrarë më të shënuara të Letërsisë së modernitetit. Për të ilustruar këtë përfundim mjafton të krahasojmë çifte autorësh me profil të përafërt të dy periudhave: Në tekstet e Zef Zorbës identifikohet forma eliptike e teksteve të Migjenit. Tekstet letrare të Zef Zorbës janë hermetike, sikurse mjaft tekste të Asdrenit dhe Migjenit. Energjia estetike e teksteve të Migjenit është e pranishme me të njëjtën dritë dhe forcë edhe te tekstet letrare të Zef Zorbës. Ligjërimi poetik i Zef Zorbës është i ndikuar nga poezia më e mirë botërore, sikurse edhe ligjërimi poetik i Migjenit. Dhuna që vjen nga jashtë dallohet qartë në tekstet ekzistencialiste të Zef Zorbës, dukuri që ndeshet edhe në tekstet letrare ekzistencialiste të Migjenit. E njëjta pranëvënie mund të bëhet midis teksteve letrare të drejtpërdrejtë, me tematikë politike të Fan Nolit me tekstet letrare me të njëjtën tematikë të Trifon Xhagjikës. Mund të pranëvëmë për nga niveli artistik pa asnjë mëdyshje tekstet letrare të Ernest Koloqit me tekstet letrare të poetit emblematik të Letërsisë së penguar Frederik Rreshpja. Mendojmë se nuk kërkohet guxim për të krahasuar tekstet poetikë të Lasgush Poradecit me tekstet poetike të Mihal Hanxharit. Të dy poetët i kanë kënduar me mjeshtëri dashurisë si materie substanciale nga e cila bota është bërë, dashurisë si vetëflijim dhe si përherëshmëri. Kur themi se Letërsia e penguar i ruajti tiparet më të mira të Letërsisë së modernitetit kemi parasysh pikërisht ruajtjen e letërsisë si e tillë, pa u kthyer në letërsi të qëllim të, duke mos humbur substancën letrare dhe duke mos u shndërruar në tekst propagandistik. Arrijmë në përfundimin se rrjedha e Letërsisë së modernitetit e ndërprerë dhunshëm në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore vijoi rrjedhënesajshkrimtari dhe si tekst letrar herë në dritë të diellit dhe herë fshehur në shtratin e brishtë të Letërsisë së penguar. Kur themi Letërsi e penguar nënkuptojmë atë letërsi që është krijuar në

burg, por është penguar të botohet, atë letërsi që është krijuar jashtë burgut, por gjithashtu është penguar të botohet, edhe atë letërsi që qe botuar dhe është ndaluar duke u penguar që të lexohet, edhe atë letërsi që nuk qe krijuar, sepse pengohet të lindte nga klima e terrorit, por do të lindte kur kjo klimë do të ndërronte, edhe atë letërsi që qe krijuar në mendjen e shkrimtarit, por qe penguar për t'u hedhur në letër nga frika, edhe atë letërsi që qe krijuar dhe shkruar, por nuk qe çuar kurrë për botim, sepse pengohet prej frikës, por që u shfaq pas rënies së diktaturës dhe shkaktoi habi estetike, edhe atë letërsi që është krijuar, është çuar për botim, por botimi qe penguar për shkak se nuk përmbushte kriteret e realizmit socialist. Letërsia e penguar, krahas tipologjisë së përbashkët me Letërsinë e modernitetit, duke u zhvilluar në një kohë tjetër, u pasurua edhe me tiparet e letërsisë europiane, si në formë dhe në përmbajtje. Kjo u vu re në tekstet letrare të autorëve më të spikatur të kësaj letërsie. Ndonëse u krijuar në një klimë aspak të përshtatshme, ndonëse lidhjet me botën e qytetëruar u ndërpre në muret e izolimit total të qytetërimit shqiptar me botën. Letërsia e penguar për shkak të inercisë nga letërsia pararendëse dhe për shkak të mosaplikimit të parimeve dogmatike të socrealizmit në procesin krijues nga krijuesit e kësaj letërsie, shfaqet sot me një prurje serioze në shtratin e begatë të Letërsisë shqipe. Në tekstet letrare të kësaj prurjeje takojmë univertet me dilemat e tij ekzistencialiste. Më e prekshme kjo dukuri gjendet në tekstet letrare të Zef Zorbës, Mihal Hanxharit, Visar Zhitit, Jamarbër Markos. Në tekstet letrare të këtyre autorëve gjen të njëjtin shqetësim e trazim të unit poetik, sikurse në tekstet letrare të autorëve bashkëkohorë si metamorfoza e tjetërsimi i individit si rezultat i uniformizimit të shoqërisë dhe dhunës së fatit, dhunës së turmës, dhunës së përditshmërisë. Letërsia e penguar u zhvillua si rrjedhë më vete e Letërsisë shqipe, por edhe brenda shtratit të realizmit socialist si kundër-rrjedhë. Këtë pjesë të Letërsisë së penguar ne e kemi emërtuar Letërsia e Purgatorit. Është e vështirë ta përkufizosh Letërsinë e penguar si një dukuri unike letrare. Ajo u krijuar dhe u shkrua në burg, por u krijuar dhe u shkrua edhe në shtratin e Letërsisë së realizmit socialist, siç ka ndodhur me ato tekstet letrare të Letërsisë së penguar, që ne i kemi emërtuar si Letërsia e Purgatorit. Ky emërtim lidhet më tepër me fatin e autorëve të këtyre teksteve, të cilët janë shkrimtarë me tekste të botuara, por për shkak se nuk e kanë përqaftuar me devotshmëri metodën dogmatike të realizmit socialist kanë krijuar tekste jashtë parimeve të kësaj “metode”. Këto tekste letrare janë dënuar duke u shndërruar në karton ose duke u “burgosur” në fondet rezervë të bibliotekave. Autorët e tyre janë larguar nga qyteti dhe profesionit i tyre dhe janë detyruar të shkojnë të banojnë në zonat rurale për t'u edukuar me frymën e klasës punëtore, duke kryer punë të rënda si minatorë, punëtorë ndërtimi apo kooperativistë. Ky qëndrim në “purgator” zgjatej për vite të tëra ose gjatë gjithë jetës. Në Letërsinë e purgatorit si pjesë e Letërsisë së penguar bëjnë pjesë tekstet letrare të dënu-

ara të autorëve si Ismail Kadare, Dhori Qiriaz, Sadik Bejko, Zija Çela, Dhimitër Xhuvani, Koço Kosta, Moikom Zeqo, Xhevahir Spahiu, Bujar Xhaferi, etj. Këto tekste, ndonëse panë dritën e botimit, u kritikuan, u nëmën dhe u burgosën në fondin e rezervuar të bibliotekave, duke pësuar fatkeqësinë më të rëndë, humbjen e lexuesit. Autorët e Letërsisë së purgatorit kanë krijuar tekste letrare me nivel të lartë artistik, por kanë paguar “haraçin” duke shkruar edhe tekste propagandistikë në këmbim të botimit të teksteve të tjerë me vlera letrare. Në tekstet letrare të këtyre autorëve dallohen ku më zbehtë e ku më qartë “tatuazhet” e metodës së realizmit socialist. Letërsia e penguar është shprehje e disidencës estetike me letërsinë zyrtare të gjysmës së dytë të Shekullit XX. Pas shqyrtimit të teksteve letrare të Letërsisë së penguar vijmë në përfundimin se kjo letërsi i ka shpëtuar morsës së socrealizmit, ndonëse, siç jemi shprehur më lart, aty- këtu nëpër tekstet letrare të saj dallohen tatuazhet e metodës së realizmit socialist, sidomos tek tekstet letrare të Letërsisë së purgatorit. Them i se kjo letërsi është shprehje e disidencës estetike në lidhje me letërsinë zyrtare, sepse nuk ndoqi parimet dogmatike të socrealizmit, sipas të cilave qe ngjizur teksti i letërsisë zyrtare, por ndoqi parimet estetike të nyjetimit të një teksti, ku forma, e bukura, letrarja, humanizmi janë të panegocueshme nga krijuesi. Termi disidencë estetike, mendojmë është një term i diskutueshëm, por në përdorimin tonë do të thotë refuzim i parimeve të tilla dogmatike si partishmëria proletare, krijimi i heroit pozitiv, etj., refuzim i asaj letërsie që u shkrua në vitet 50 - 60, ku euforia për fitoren, urrejtja ndaj armiqve të brendshëm dhe armiqve të jashtëm i kishte “çmineralizuar” tekstet nga letrarja duke i kthyer thjesht në propagandë. Disidencë estetike në Letërsinë e penguar ka qenë herë e hapur, herë e fshehur sipas klimës që krijohej në diktaturë. Disa nga shkrimtarët e shquar të viteve '60 nyjëtuan tekste letrare që shkaktuan mjaft polemika midis tyre dhe brezit të shkrimtarëve pararendës. Ndërsa krijimtaria e disa poetëve të Letërsisë së penguaris Zef Zorba, Mihal Hanxhari, Frederik Rreshpja, Visar Zhitit është qartas e dallueshme nga letërsia zyrtare e socrealizmit në të gjithë komponentët e saj. Krahas disidencës estetike në letërsi, në gjysmën e dytë të Shekullit XX, ka ekzistuar edhe disidencë politike nga shkrimtarë dhe tekstet e tyre të krijuara jashtë dhe brenda burgut. Lexuesit të sotëm nuk besojmë se i intereson disidencë politike e shkrimtarit. Atij i mjafton teksti letrar dhe nuk ka ndonjë interes për fatin e autorit, apo qëndrimet e tij politike e shoqërore. Nëse teksti përmbush pritshmëritë e tij estetike, lexuesi është indiferent për fatin e autorit. Në këtë punim kemi sjellë shembuj të disidencës estetike, por edhe të disidencës politike në tekstet letrare të krijuesve të Letërsisë së penguar. Tekstet më të spikatur të këtyre llojeve i gjejmë në krijimtarinë e poetit disident Arshi Pipa, ku vizatohet me mjeshtëri dhuna dhe rrjedhojat e saj mbi qytetarët shqiptarë. Tekstet e Trifon Xhagjikës janë tekste që goditin hapur, në mënyrë të drejtpërdrejtë

diktaturën, diktatorin dhe dhunën e ushtruar mbi shqiptarët. Për këtë arsye poeti martir u dënua me vdekje, duke qënë një nga shembujt emblematikë në të gjithë Lindjen europiane të përballjes së guximshme të poetit me diktaturën. Tekstet me temë politike i gjejmë edhe tek poeti tjetër martir, Havzi Nela, i cili në kërkim të lirisë së munguar stigmatizon diktaturën, si mbytëse të lirisë. Edhe në tekstet e disa shkrimtarëve të tjerë të Letërsisë së penguar dallojmë disidencën politike, si nëntekst, duke ndjekur pesë parimet për të thënë të vërtetën në diktaturë për të cilat flet shkrimtarit Bertold Breht. Shpesh është artikuluarsenë Shqipëri nuk ka patur shkrimtarë disidentë. Në Shqipëri ka pasur shkrimtarë që me tekstet e tyre krijuan disidencë estetike në letërsi dhe shkrimtarë të tjerë që nëpërmjet teksteve të tyre letrare, por edhe nëpërmjet veprimtarisë së tyre shoqërore kanë qenë disidentë të hapur politikë duke denononuar dhunën, mungesën e lirisë, krimet ndaj qytetarëve të këtij vendi. Letërsia e penguar përmes rezistencës estetike të shkrimtarëve të saj arriti të ruajë letraren, arriti të ruajë qenësinë e saj si letërsi dhe si rrjedhojë arriti të mbetet letërsi si e tillë. Për të argumentuar këtë tezë na vjen në ndihmë koha, si redaktorja më e mirë e teksteve letrare. Mjaft tekste letrare të promovuar me zhurmë në shtypin letrar dhe nëpër takime krijuesish, sot i bëjnë të skuqen autorët e tyre për faktin fatkeq të shkrimit të tyre. Mjaft emra të shkrimtarëve të socrealizmit, të cilët mbushnin bibliotekat e vendit me tekstet e tyre sot janë harruar dhe nuk njihen nga lexuesit. Ndërsa tekstet e Letërsisë së penguar, pavarësisht fatit të tyre prej hirusheje, sot lexohen dhe rilexohen. Tekstet poetikë të Frederik Rreshpjes, Visar Zhitit, Zef Zorbës, Mihal Hanxharit, Jamarbër Markos shkaktuan habi estetike të lexuesit, ndonëse patën fatin e teksteve letrare të ekskomunikuar për dekada të tëra për shkaqe joletrare. Letërsia që i bëri ballë kohës dhe diktaturës qe letërsia e nyjëtuar sipas parimeve estetike. Tekstet që arritën të ruanin substancën e tyre letrare falë talentit letrar dhe vetëdijes prej krijuesi të autorëve të tyre sot përbëjnë atë që ne e kemi emërtuar si Letërsia e penguar. Tematika e Letërsisë së penguar është e larmishme. Fati i individit përballë dhunës së shtetit, tjetërsimi i njeriut si pasojë e dhunës, metamorfoza si dukuri traumatike në diktaturë, roli i turmës në diktaturë, bjerrja e virtyteve të formuara ndër shekuj për shkak të terrorit shtetëror, përballja e dashurisë me urrejtjen në shoqërinë diktatoriale, zhveshja e një shoqëria nga humanizmi dhe zëvendësimi i tij me urrejtjen klasore, atdheu si përhershëmëri dhe diktatura si përkohshmëri, dashuria si streha e vetme në diktaturë, janë disa nga temat e trajtuara në tekstet e kësaj letërsie. Duke studiuar tekstet letrare të poetit Arshi Pipa vijmë në përfundimin se autori asnjëherë nuk e identifikon diktaturën me atdheun, por e sheh atdheun si viktimitë e diktaturës duke e identifikuar me veten. Dhuna e diktaturës ndaj qytetarëve shqiptarë shihet si dhunë mbi atdheun, gjithashtu diktatura identifikohet si rrënuese e qytetërimit të krijuar në mijëra vjet. Nga

shqyrtimi i teksteve lirike të poetit Arshi Pipa, vijmë në përfundimin se poezia për poetin është dashuri, zbulim, takim me të bukurën, krijim i saj, kërkim i së vërtetës artistike e kuptimore, edukim i shpirtit, fisnikëri, atdhetari, formëekzistence. Tipologjia e diskurseve të "Letërsia e penguar". Tekstet e "Letërsisë së penguar", duke qenë se u krijuan në një hark kohor mjaft të gjerë që përfshin disa dekada, duke u krijuar nga shkrimtarë dhe poetë që përfaqësojnë disa gjenerata, formojnë një spektër në llojet e diskurseve, qoftë në aksin semantik, po ashtu edhe në aksin estetik të tekstit. Nga shqyrtimi i tipologjisë së diskurseve dallojmë tekste me diskurse realiste, romantike, futuriste, hermetike, simboliste etj. Diskursi realist vjen si inerci dhe përvojë nga poetë dhe shkrimtarë të shquar të "Letërsisë së modernitetit". Tekstet poetikë të poetëve Visar Zhiti, Bilal Xhaferi, Sadik Bejko, Genc Leka, Havzi Nela, Zyhdi Morava, Pano Taçi etj. janë tekste letrare me diskurs realist. Tekste me diskurs futurist, apo me futurizmin si prani ndeshen në krijimtarinë e poetëve të viteve '60 si ndikim nga futurizmi rus e ndoshta më pak nga futurizmi Italian. Ne jemi ndalur te poema me diskurs futurist e poetit të nëmur Faslli Haliti. Tekstet me diskurs simbolist i kemi ndeshur në tekstet letrare të poetit martir Wilson Blloshmi, të poetëve Frederik Rreshpja dhe Mihal Hanxhari etj. Tekstet me diskurs hermetik janë, për mendimin tonë, dukuria më interesante në "Letërsinë e penguar". Këto tekste i ndeshim në krijimtarinë poetike të poetëve Zef Zorba dhe Jamarbër Marko. Tekstet e këtyre poetëve nuk kanë asnjë funksion tjetër, veç funksionit estetik, gjë ende e rrallë në poezinë shqipe, e cila edhe kur i shpëtoi 39 morsës së socrealizmit, nuk i shpëtoi të qenit si letërsi funksionale, qëllimore a tendencioze. m. Tekstet e "Letërsisë së penguar" me modelimin, rimodelimin dhe destruksionin e miteve shënuan një kulm të poetikës në "Letërsinë shqipe". Letërsia ka lindur nga mitet dhe ushqehet nga mitologjia. Pas studimit të teksteve të "Letërsisë së penguar", vijmë në përfundimin se në tekstet e saj ndeshen mitet si miti i lirisë, miti i atdheut, miti i Sizifit, miti i Hënës, miti i kohës, miti i Itakës, miti i Perëndimit, miti i metamorfozës, miti i femrës, miti i humbjes, miti i ringjalljes, miti i vetmisë, miti i mungesës, miti i dashurisë etj. Një nga mitet që ndeshet shpesh në "Letërsinë e penguar" është miti i humbjes. Nga analiza e teksteve letrare kemi ardhur në përfundimin se në "Letërsinë e penguar" dhe në të gjithë "Letërsinë shqipe" nuk gjen asnjë poet që me aq ashk t'i ketë kënduar humbjes sa poeti Frederik Rreshpja. Ai mund të cilësohet si Kad-

YZEDIN HIMA

LETËRSIA E PENGUAR
DHE MITET E SAJ

Zef Zorbës, *Kur s'ka dritë ç'i do sytë*, janë përkufizimi më i qartë i raportit të poetit me diktaturën. Krahasimit të humbjes në tekstet letrare të të kësaj letërsie takohet miti i metamorfozës. Në baladat dhe legjendat 40 shndërrimi, metamorfoza ndodh kur personazhet pësojnë trauma të forta shpirtërore, ku ata gjenden në situata të pazakonta, të cilat kërkojnë energji të jashtëzakonshme jashtënjerezore për të zgjidhur këto situata. Miti i metamorfozës ndeshet pothuaj në tekstet e të gjithë poetëve dhe shkrimtarëve të "Letërsisë së penguar". Nga shqyrtimi i teksteve letrare të Visar Zhitit vijmë në përfundimin se metamorfoza në tekstet e tij përfshin edhe qenie të gjalla edhe sende e objekte pa shpirt. Poeti Visar Zhiti, në tekstet e tij, shndërrimin, tjetërsimin, pra metamorfozën e individit të burgosur e shikon si të pakthyeshëm. Nga studimi i teksteve të këtij poeti vijmë në përfundimin se diktatura me metodat e saj diabolike synonte çnjerëzimin dhe tjetërsimin si një proces terrorist të vazhdueshëm. Gjithashtu mësojmë se i gjithë diskursi poetik i teksteve të Visar Zhitit thuret nga fije humanizmi. Metamorfoza e gishtërinjve të

Zhitit miti i metamorfozës përdoret më shpesh në funksion të rrafshit semantik të tekstit, te Frederik Rreshpja miti i metamorfozës përdoret pothuajse në të gjitha rastet në funksion të rrafshit estetik të tekstit. Uni poetik në diskursin poetik të Frederik Rreshpjes ndihet më komod i pranës nga zinxhiri i humbjeve se sa nga komforti që vjen si rrjedhojë e procesit të shndërrimeve dhe konvertimeve, ndaj kur ndjen se duhet të shndërrohet, ai zgjedh vdekjen, si shndërrim sublim. Ndërsa nga shqyrtimi i teksteve poetikë të Mihal Hanxharit vijmë në përfundimin se dukuritë, objektet, njerëzit, ngjyrat, tingujt, format shfaqen në një dritë zanafillore, që projekton skenën e pandërprerë të shndërrimeve të tyre. Kjo mënyrë konceptimi e ndihmon mjaft poetin për të ndërtuar realitete artistike, ku shenjat sjellin imazhe të gjalla të shndërrimeve nga zanafilla deri në çastin fatlumë të shfaqjes. Dashuria është një arsye madhore në tekstet poetike të Mihal Hanxharit, që me mungesën e saj, shkakton metamorfoza traumatike. Tekstet dhe veprat letrare të Letërsisë së penguar zënë një vend të nderuar në hierarkinë e vlerave të

Letërsisë shqipe. Mjaft tekste letrare të Letërsisë së penguar kanë zënë vend në fondin e artë të letërsisë shqipe siç janë tekstet poetikë të poetëve Frederik Rreshpja, Zef Zorba, Visar Zhiti, Mihal Hanxhari, Jamarbër Marko. Gjuha ka qenë streha e poetëve dhe krijuesve në diktaturë, natyrisht dhe shpëtimi i tyre. Arrimë në përfundimin se pikërisht gjuha është edhe terreni ku duhet gërmuar për të zbuluar dhe njohur më mirë tekstet letrare dhe autorët e tyre. Jo vetëm për poetët që u pushkatuan apo u varën si Vinçenc Prenushi, Wilson Blloshmi, Genc Leka, Trifon Xhagjika, Havzi Nela, por edhe të tjerët e përdorën gjuhën edhe si strehë, edhe si mjet shprehës, edhe si refuzim të së përditshmes për të jetuar përhershëmërinë si Lasgush Poradeci, Zef Zorba, Frederik Rreshpja, Visar Zhiti, Maks Velo etj. Gjuha, sikurse edhe nëntoka, ruan dhe fsheh mistere, të cilat duhen zbuluar pikërisht duke hulumtuar në gjuhën e teksteve letrare të shkrimtarëve të Letërsisë së penguar. Tek tekstet e shkrimtarëve kemi zbuluar mjaft të panjohura të fshehura në gjuhë. Synimi ynë që që nëpërmjet leximit të kësaj gjuhe të zbulonim dhe hidhnim dritë mbi misteret e krijimit në diktaturë. Censura, autocensura ka krijuar mjete dhe detale të gjuhës poetike, të cilat fshihnin brenda formës së rafinuar mesazhin artistik e kuptimor. Tekstet me diskurs hermetik janë, për mendimin tonë, dukuria më interesante në Letërsinë e penguar. Këto tekste i ndeshim në krijimtarinë poetike të poetëve Zef Zorba dhe Jamarbër Marko. Tekstet e këtyre poetëve nuk kanë asnjë funksion tjetër, veç funksionit estetik, gjë ende e rrallë në poezinë shqipe, e cila edhe kur i shpëtoi morsës së socrealizmit, nuk i shpëtoi të qenit si letërsi funksionale, qëllimore a tendencioze. Gjithashtu vijmë në përfundimin se Letërsia e penguar është pjesë e rëndësishme e letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX. Kjo letërsi nuk vjen si mohim i një letërsie, si mohim i një teksti, apo autori. Ajo vjen dhe zë vendin e saj të mohuar për arsye jashtë-letrare për dekada të tëra. Ajo vjen dhe zë vendin bosh në mozaikun e Letërsisë shqipe. Natyrisht kërkohet nga studiuesit, hartuesit e teksteve shkollore vëmendje më e madhe për ta publikuar këtë letërsi me të vetmin kriter vlerësues, atë artistik. Letërsia e penguar është ende e panjohur për lexuesin e gjerë dhe jo fort e përfaqësuar në tekstet shkollore, ndonëse mbart te vetja vlera të spikatura artistike dhe njerëzore. Mungesa e poetëve Frederik Rreshpja, Zef Zorba, Mihal Hanxhari, Visar Zhiti, Jamarbër Marko në tekstet shkollore, nuk dëmton këta autorë, por formimin letrar e estetik të nxënësve.

Poezi : Primo Shllaku

EUTANAZI

Kam ardhë pranë teje
te kryet e shtratit,
afër t'jam qasë,
mbi të njajtin jastëk kryet e kam pshtetë
e pranë gojës tande veshin kam vu
që ta ndigjoj plotësisht unë grahamën,
ecejakën e ashpër të frymës

Prej ktu ku jam
gjithçka është një botë zani.
Rropama ndigjoj, kuajt e erës, hingëllimat e shtrëngatës.

Krisma e akullit
si falangë e pamposhtur
kërcënueshëm avancon mbi kaçurrela engjëjsh
e lapa pleqsh,
mbi lëkurën e nxehtë
e ernat e athta të trupit,
mbi telat e kitarës
e partiturën e djegun.
Të gjitha tërhiqen për një kputje të njëçastshme
e këtë pritje të tendosun,
ma s'e duroj këtë pritje,
si pritjen para plasjes së minës.

Ktu në dorë i kam dekoratat.
Nji nga nji po t'i ve në gjoks

Karficat në mish t'i ngula
se rroba s'ke,
je lakuriq.
Ato të takojnë
vetë i fitove
si kampion i hjedhjes me krye teposhtë
ndër hone të thata.
Jeta jote – fluturim i pakputun
teposhtë
me sytë e mbyllun
drejt tehut të shkambit.
Nji jetë që balli yt
frikshëm i afrohet thepit ma të mprehtë...
E s'e takon,
e s'e takon...
Kjo jeta e jote, ky fluturim i lirë,

ky ballë që kërkon një thep,
ky thep që driblon një ballë...

Gjak nuk të qiti
lëkura,
as mishi.
Karfica u ngul e shurdhët
e dekoratat përpëliten tashti
me dallgën e grahmës tande.

Tash fryma jote kahen e ndrroi.
Te dyert e gojës
nji turmë e madhe fjalësh
zhurmon e shtyhet.

Kur ishte koha
ti flisje me gjeste,
me të pakta gjeste ose me fjalë njërrrokëshe.
Të dinim për memec.

Ma afër ta solla veshin te goja,
që ndonji fjalë prej tyne
veshi të ma kapë
e amanetin ta marr
si kurrnji ma i afërt
në këtë ditë solemne

Shpellat e akullit
e ligjet e borës
i more në gojë e fjalët u ngrinë.
U ndie mbas pak krisma e akullit
e plasja e fjalëve.

Nji fjalë desha prej teje
e atë s'ma dhe.
Më qerese akull të plasun
e fjalë të tejdukshme.
Vetëm pak përpara
të gjitha ato fjalë
t'i shkallmonin prej brenda dhambët
për me dalë deri në buzë.

Faqe më faqe me ty jam shtri.
Mes nesh po ngrihet xhami.

Tash që s'ke asgja për me thanë,
tash që s'kam asgja për me ta dhanë,
pranë teje do rri deri në fund.


Do të pres sa të zbrazesh,
do të pres sa të ftohesh.
Në një jastëk jemi mprehun,
prej ktu nuk iki.
Le të shkojë sa të shkojë.
Ngadalë do të të ndihmoj
që të vdesësh...



Qasje

TRIUMFI I SHPIRTIT MBI ZYMTËSINË

Albana M. Lifshin është ndër të paktat krijuese shqiptare që poezinë nuk e ngarkon me fjalë e me sekuenca trishtimi



Ali PODRIMJA

Poezinë e përcjell vetëm kur lëshon shtat mes zjarrit e fjalëve. Kemi të bëjmë me diçka që ia afrohet filigranizmit deri në përsosje të tekstit kur hedh nga trupi fjalët e tepërta ose ndonjë figurë që mjegullon horizontin, pra kur krijuesi është i përqendruar të artikulimi ekuivok. Të tmerrshme janë bredhjet e skribomanëve që humbin durimin dhe nuk dinë ta gjejnë rrugën për tek e bukura. Poetessa e njohur suedeze Linda Aberg thotë: "Është vështirë të shkruash shkurt". Poezia është diçka që lëviz dhe mban gjallë kujtesën. Krijuesi duhet të ketë kujdes në konceptin e asaj që e hedh si ide, mesazh, ndoshta dhe me evoluimin e vetë tekstit poetik. Leximi i tekstit varet kryesisht nga qasja e recipientit: ç'dëshiron të potencojë nga mesazhet. Miku im Zija Çela mbështet se modernitetin e poezisë e mbajnë gjallë: eliptizmi dhe revolta ndaj shkarjeve shoqërore, njerëzore, nuk prajnë pra kërkimet që duhen parë ato si përpjekje për poezi të pastër dhe me vlera universale.

Përmbledhja e poezive "Ka gjithmonë diku" e Albana M. Lifshin ngërthen në vete sensibilitetin të çuditshëm, të rrallë do të thoja. Kisha përpiluar edhe më parë ndonjë libër të krijueseve shqiptare, si dhe Antologjinë e poeteve "Taket e larta", viti 2000, që më kishin mahnitur me artikullimin e mesazhet e tyre. Albana ka diçka që të nxit ta ndjekësh udhëtimin e saj imagjnativ. Tek e lexon poezinë e saj bindesh se kjo zonjë e letrave shqipe vë në funksion njerëzoren, i rri anash vorbullës së asociacioneve trishtuese, ndërsa recipienti shpalos gjuhën e figurave, na shëtit deri të enigma "në përkryerjen ritmike e kuptimore të tekstit poetik", siç do të thoshte Ezra Pound. Tek i bashkohemi udhëtimin të saj, në të vërtetë hulumtojmë vlerat kulminante në librin e përmendur me titull domethënës "Ka gjithmonë diku", që nuk janë të pakta. Disi na kujtohet John Ashbery dhe vargu i tij "Thjesht të jetuarit nuk mjafton". Trokasim në botën e sekreteve, të intensitetit të ndjenjës së dashurisë, megjithëse" ndjeshmëria, siç shkru-

an ELIOTI ndryshon nga një brez në tjetrin, duam apo s'duam ne..." Temat e mëdha si vdekja e identiteti i rrezikuar pranohen shpesh si poezi dokument. Ikëtim mendimi është edhe kritiku e poeti polak Leszek Szaruga. Tek kaloja kufirin vdekjeprurës mes Bllacës e Dardanisë nën ushtimën e plumbave të padukshëm kisha vërejtur imazhin e antikitetit: një nënë e re e tmerruar vraponte drejt turmës së pafundmë 1999, tërhiqte një fëmijë përdore ndërsa tjetrit ia afronte gjirin, por fëmija fatkeqësisht ishte i vdekur. Kuja e saj kishte ngritur në këmbë një botë të tërë të ekzodit. Më vonë e shkrova poezinë që ishte: dëshmi e hidhur e tragjedisë së ndodhur në fund të shekullit XX. Albana M. Lifshin është ndër të paktat krijuese shqiptare që poezinë nuk e ngarkon me fjalë e me sekuenca trishtimi, u rri anash tërmeteve shpirtërore dhe mbështet se "gjërat duhen thënë bukur e me dinjitet, qoftë edhe përmes një skice apo poezie erotike se jeta njerëzore është kompleks ndjenjash e fatesh; aty asgjë nuk është tabu as privi-

legj për njërën anë të duetit." Mund të elaborohen në detaje edhe gjërat më intime të qenies njerëzore, se arti kërkon të pamundshmen. Madhështinë si krijuese dhe njeri, Albana arriti ta thotë përmes shumë poezive të saj vërtetë antologjike. Me këtë rast dua të kujtojme vargjet brilantete "Shkalla e poezisë", por kjo nuk është e vetmja në këtë përmbledhje. Po ashtu titulli i librit nxit të mendosh se ç'është ajo që gjithmonë gjendet diku. Mbetet kjo enigmë edhe për recipientin. Në pyetje është kujtesa, se drama njerëzore u reprizua shpesh në Gadishullin Ilirik dhe atë epaguamshtrenjtë... Poeteshën e ndjek kjo frikë qoftë përmes njerëzve të saj, që i njehe apo të atyre që u bënë dhe atdheu. Nuk pranon të ngre dorë nga himnizimi i dashurisë, se dashuria është diçka hyjnore. Është e bindur se vetëm nuri isajmund ta shpëtoj njeriun nga apokalipsi. Përmbledhja e poezive të Albanës shënon triumfin e shpirtit mbi zymtësinë që kishte pushtuar hapësinë e gjallimit tonë. (Ulpijanë, 2010)

Ese


NUSJA QË U KTHYE NË MURGESHË

Shkrimtari ka një mjet, që t`i sjellë në kohë gjërat, sado larg qofshin dhe ky është arti. Nëse s`do ishte arti, Homeri do ishte po aq i harruar sa mumiet e piramidave

Fatbardh AMRUSI

Romani "Martesa e palumtur e Stanishit" i Dashnor Kokonozi, të vinte tek unë duhej të kapërcente oqeanin, ndërsa e nusja e Stanishit që të shkonte në shtëpinë e burrit duhej të kapërcente Adriatikun. Përsa i përket ngjarjeve dhe personazheve na duhet të kthehemi pesë shekuj pas. Mos do ishte më mirë të thosha, se shkrimtari ka një mjet, që t`i sjellë në kohë gjërat, sado larg qofshin dhe ky është arti. Nëse s`do ishte arti, Homeri do ishte po aq i harruar sa mumiet e piramidave. (Kur i shkruan një kolegu, përherë ndruhesh mos po lë vend për keqkuptim, jo për huqet, por për mendimin, që ata mund të kenë për veten dhe ti s`u afrosh pretendimeve të tyre. Edhe pse bëjnë thirrje të shkruajnë për njeri-tjetrin, preferohet një i palës së tretë.) Romani është i mbushur me të papritura, që i sjellë sa koha, por dhe interesat. Nis si gëzim dhe kthehet në vuajtje, ku nusja përfundon në një murgeshë. Dikush detyrohet të luaj rolin e dhëndërit, duke e kthyer një marrëdhënie serioze në aventurë. Them serioze, se viheshin në rrezik dhe marrëdhëniet midis principatave. Kur lexojmë përngajmë ca me kërkuesit e arit, është fjala për detajet, sikurse ky: "Shpesh marinarët e dikurshëm do të zëvendësoheshin me kriminelë që vuanin dënimin duke u dhënë rremave." Shenjat e para të tronditjeve shoqërore shfaqen tek kush merr protagonizëm. Marinarët ndërrojnë vend me kriminelët, sikurse dhëndëri do të ndërronte vend me dasmorin. Jetohej në një realitet të dubluar, sikurse pritet të ndodh me Shkodrën, që Balshajt ia shiten Venedikut dhe turqit vijnë për ta pushtuar. (Kish nga mësonte dhe mbreti Zog.) Askush nuk e di se ç`e nesërme e pret. "Kishte venecianë që besonin se bija e vetme e sior Orseolos, për arsye shtetërore do të martohet me një kreshnik, një farë gjysmë përbindëshi, këmbët e të cilit dilnin tutje dritares së stallës ku flinte, në një kullë majë malit." Ky pasazh më kujtoi "Manastirin e Parmës" të Stendalit, ku priftërinjtë i mallko

nin ushtarët e Napoleonit si të ishin jushave që i kishin humbur burrat



përbindësha. Kur damat panë ca djem të rinj, të veshur keq, të ndrojtur, ranë në dashuri me ta. "Valeria kishte ëndje të mbështeste kokën te supi i tij e të qante pa zë. Veçse druhej. Nuk e dinte ende nëse në anët e tij, një grua mund të mbështeste kokën te burri i saj në sy të të gjithëve." Edhe ky detaj tregon diferencën në mentalitet. "Në fillim kishte qenë dashuria e Stanishit, që kish nisur nga një portret i saj i pikturuar. Kjo qe e vërtetë. Ajo e saja kishte nisur si një kureshtje ditën kur dëgjoji se përtej detit, një djalë fisnik marrosee për të. E bija e prodhuesit të anijeve, e cila shkonte shtëpi më shtëpi në ndihmë të ve-

në betejë me turqit", pranon të shkoj nuse në Shkodër. Jemi ende në kohën e princave, pa mbërritur pashallarët. E ëma e Valerisë si një grua e denjë e kohës së saj, i kishte dalë para gjithçkaje duke u kujdesur që vajza të ruante deri në fund virgjërinë. Për më shumë siguri, kishte dhënë porosi që kafshët shtëpiake që kishin në pallatin e tyre, të ishin të së njëjtës gjini, meshkuj ose femra. Valeria nuk duhej të mësonte para martesë pse Noe kishte marrë në varkë specia të të dy gjinive. Dita e dasmës qe shpallur, por Stanishi ishte ende në shtat. Qytetikërcënohej nga epidemia e kolërisë. Vargani i shëruesve që zbrisnin

nga mali me trastën plot barna, gjethe, gjemba mrekullibërës, thonj arinjsh të bjeshkëve dhe sy hardhucash të verdha, arrijnë ta shpëtojnë nga vdekja. U vendos që në vend të Stanishit, në Venedik të shkonte Gjura Banovina, vëllami i Stanishit. Djemtë ishin rritur në miqësinë e lidhur që në fëmijërinë e tyre. Nëse njëri rënkonte tjetri po dalldisej. "Kur mbeti krejt lakuriq, Gjura e mbërtheu nga mesi dhe e uli ngadalë mbi shtroja. Mori kandilin dhe nisi t`ia kalojë ngadalë mbi trup, si t`i zbulonte e numëronte nishanet që kishte. I pa me radhë gjinjët, gushën pastaj e zgjati kraun mbi kërkthizë dhe deri poshtë. Aty kandili qëndroi diçka më shumë." Sa cinike do dukej shprehja: Stanishi po i mban kandilin shokut?! Kur Valerën do ta çonin në dhomën e Stanishit, ajo përjeton një çast tmerri. Kur u thotë kalorësve pse e kishin sjellë aty, Stanishi drejton dorën te një pikturë që ndriçohet turbull nga kandili i sapondezur. Valeria njohu portretin e saj. Atë që ishte në zanafillë të gjithë asaj historie. Valeria s` ishte më një grua që kalonte nëpër oborret e kalasë pa kthyer njeri kokën ta shohë. Kishte që e vështronin shtrembër, se mendonin që ajo sillte fatkeqësi. Gratë e reja ndërrojnë rrugë tek e shihnin. Kishin dëgjuar se ajo ngjitej natën mureve të kështjellës për të takuar të dashurin e munguar, deri sa përfundoi në një murgeshë, kur të tjera do të binin në robina të turqve. Është nga rastet e rralla, për aq sa kam lexuar, që disa rreshta të kenë aq shumë vlerë, duke ia shtuar romanit dimensionet, sikurse këto: "Nga ana e tyre, venecianët vazhdonin ta dëgjonin gjithnjë, deri në fund, historinë e martesës së lumtur të Valerias me një princ të bukur të një vendi të largët, përtej detit." Duke i ardhur fundit të shkrimit, mu kujtua një autore, e cila shkruante për librin e një shkrimtari, se e kishte gdhirë për gjithë natën duke lexuar, ndërsa i shoqi flinte. Martesa e ktheu nusen në murgeshë, se dasma ishte para së gjithash një pazar interesash, ndërsa gruaja që i fali një natë librit është e përjashtuar nga leverditë klienteliste.

Koha letrare e një antologjie

LULE PËR LULET

Antologjia është një dhuratë e çmueshme e fatlume, që ka një të djeshme, ka një të sotme dhe me gjuhën e zemrës e të shpirtit të krijuesit i flet së ardhmes

Xhahid BUSHATI

"Lule për lulet" është Antologjia e parë e Letërsisë shqipe për fëmijët e rinj pas

viteve '90, e cila përfshin një prodhim letrar: 2000-2014. Antologjia është pasaporta e identitetit që Letërsia shqipe për fëmijë e të rinj, kësaj

here e jep përmes krijimeve të gjen-eratave të shkrimtarëve shqiptarë. "Lule për lulet" brenda ndërtimit të saj të harmonishëm mbart marrëdhënie

përrallore, floreale dhe poetike. Siç shprehet studiuesja Zenepe Alili - Rexhepi: "Vepra "Lule për lulet" e përzgjedhur si


simbol identiteti letrar nga letërsia për fëmijë, e krijuar në kohështrirje 2000-2014, në një farë forme shquhet për natyrën kritike, sintezën e shkëlqyeshme, për modelin dhe metodologjinë, jo vetëm për poezitë dhe prozat origjinale, por edhe shqetësimet, situatat, dramat, vlerat estetike, virtytet njerëzore, qytetare, intelektuale... Një krijimtari e sjellur mjaft bukur, si një tufëzë shumëngjyrëshe lulësh, prejku përthithet nektari i disa vlerave të shkruara, pothuajse të smerilizuara me delikatesë e përkushtim. Në këto dimensione krijimesh rrëfatet shkalla e realizimit artistik, qoftë si frymëzim letrar, qoftë si sintezë idesh dhe rrymash letrare, te të gjithë autorët e përfshirë." Antologjia "Lule për lulet" si vepër është në një marrëdhënie të shumëfishtë, ku prezantohen: individualitete letrare, koncepte estetike, kode, realitete, kultura, vizione e procese krijuese e letrare, etj., etj. Në këtë marrëdhënie polivalente, të gjithë elementët të ndërtuar gërshetohen e flasin sipas ligjeve të letërsisë, në atë çka kumton vepra (krijimi). E, në këtë marrëdhënie (autor-vepër) autori vjen me një botë plot veçanësi, ku përballet dhe ndeshet me një botë të magjishme, siç është ajo e fëmijës, dhe ku e sjellë po aq magjishëm në

tekstin letrar me poetikën e tij. Vazhdojmë më tej arsyetimin. Me talentin e tij krijuesi magjinë dhe psikikën e botës së fëmijës, e eksploron, vazhdimisht e zbulon dhe e rizbulon... Është ajo botë e autorit që ka zanafillë në embrionin e frymëzimit, ku shpalos një botë tjetër, botë mesazhesh e vizionesh, tashmë lexuesi e ka në "pronë" të tij... Kjo përftesë që i ngjan një "parfumi" erëndjellës më ndiqte e më shoqëronte krijim pas krijimi në faqet e kësaj Antologjie. Antologjia "Lule për lulet" është e prirë drejt një skeme të thjeshtë: fotografia e shkrimtarit, njohja autobiografike e bibliografike e tij; krijimi autorial, burim i krijimit (librat, revistat a dorëshkrimet). Në këtë Antologji, si në një polifoto qëndrojnë pranë e pranë brezash krijuesish, individualitete e mjeshteri artistike, stile e mënyra rrëfimi, koncepte e dukuri estetike, përvojat e talentet, këndvështrime të motiveve e ndërtime arkitekturore të krijimeve, vendlindje e mesazhe, i të jetuarit aktualisht të shkrimtarit e të ndikimit të kultura letrare, ndjesi e përgjegjshmëri, treva shqipfolëse apo nga vende evropiane e kontinente ku me dashuri artikullohet poetika dhe sintaksa shqipe etj., etj. Ashtu pranë e pranë vjen kuvendimi për botën e madhe të letrave shqipe,

me zërin e moçëm ilir e me kumbimin shqip. Në këtë këndvështrim Antologjia flet shumë, veçanërisht me parathënien e saj, por është edhe një udhërrëfyese dritëdhënëse e dritëshprese të një ecjeje të sigurt të kësaj letërsie që i flet kohës dhe të ardhmes e që të fton drejt vizioneve të reja. Në këtë Antologji janë pranë e pranë 87 krijues, që mbi bazën e statusit të tyre të shkrimtarisë, shpërfaqin me dinjitet krijimet e tyre letrare mbështetur mbi bazën e lëvrimin gjinor apo të zhanrit. I gjithë ky palimpsest jo pak i mundimshëm është kurorëzuar me shije dhe kulturë nga një grup përzgjedhës - me redaktorë **Pandeli Koçi (kryetar) Astrit Bishqemi, Fatmir Gjestila, Riza Braholli, Vangjush Saro, Vasil Premçi, Xhahid Bushati, Xhevat Sylja.** Disa karakteristika:

- Pjesën më të madhe e zë poezia me 45 autorë. Mozaiku gjinor e zhanror, si: përralla, rrëfimi, legjenda, gojëdhëna, animalistika, florealja, faunorja, didaktika... e deri te tregimi fantastiko-shkencor me 22 autorë. Tregimi i mirëfilltë me karakteristika të tij fabulore me 20 autorë. Ky shpërpjestim në fushën gjinore e zhanrore mbetet një fushë e hapur studimore për kritikën letrare për të vënë pika mbi i rreth këtyre prob-

lematikave e dukurive që kanë shenjat e tyre, që krahas vlerave paraqesin dhe mangësi të kësaj letërsie. - Çdo autor, përmes krijimit të tij, shpreh tiparet më të mira të krijimtarisë së tij, duke përcaktuar individualitetin artistik dhe shpirtin poetik përmes rrëfimit e ligjërit të tij. Por në tekstet e paraqitura është pamundur të mos vëshret në një mos-shkëputje ende nga metoda e realizmit socialist, që disa krijues, akoma nuk e kanë kapërcyer. Për mua, ky problem mbetet thelbësor ndaj kësaj Letërsie dhe kërkon studim të thelluar. - Vlerat e kësaj Antologjie përcillen përmes trajtimit të problematikës së krijimit për fëmijë me një dimension të gjerë kohor, të përpjekjes maksimale të talentit krijues për të njohur në thellësi botën dhe psikikën e fëmijës, etj., etj.; për ta përmbledhur: përkushtimi dhe idealiteti i krijuesve bën që të ekzistojë dhe të jetojë Letërsia shqipe për fëmijë e të rinj. Antologjia është një dhuratë e çmueshme e fatlume, që ka një të djeshme, ka një të sotme dhe me gjuhën e zemrës e të shpirtit të krijuesit i flet së ardhmes. Kjo është dhe arsyeja që dhurata magjike me emrin Antologji vjen si lule për lulet-fëmijë!



NUMRI I ARDHSHEM ME 15 MARS

HEJZA

01 Mars, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shala & Rexhepi

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000